



SHQIPËRIA RIAFIRMON ANGAZHIMIN NË NATO

Ministri i Mbrojtjes Ermal Nufi: Aleatë të bashkuar për një siguri më të fortë

» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN E NATO-S PËR GODITJEN ME PRECIZION NË THELLËSI

Mons, Belgjikë – Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në Simpoziumin e Goditjes me Precizion në Thellësi (Deep Precision Strike – DPS), i zhvilluar në selinë e Komandës Supreme Aleate të NATO-s (SHAPE), në Mons të Belgjikës. Ky simpozium mbledhi drejtues të lartë ushtarakë, ekspertë të planifikimit strategjik dhe përfaqësues të vendeve...

faqe 4



QENDRA QË NDRYSHON JETËT: MBËSHTETJE, TERAPI DHE SHPRESË PËR FËMIJËT E USHTARAKËVE ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT

Në zemër të komunitetit ushtarak shqiptar, prej më shumë se një dekade funksionon një nga nismat më humane dhe më të rëndësishme sociale të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes në mbështetje të familjeve të Forcave të Armatosura. Bëhet fjalë për Qendrën e Trajtitit Terapeutik dhe Edukimit për fëmijët e personelit ushtarak me çrregullime të spektrit të autizmit...

faqe 5



HAKI ÇAKO: MBROJTJA CIVILE NUK ËSHTË VETËM REAGIM NDAJ EMERGJENCAVE, POR KULTURË KOMBËTARE E SIGURISË

Intervistoi: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga strukturat e hetimit të krimit dhe drejtimi i Policisë së Shtetit, deri te ndërtimi i sistemit modern të mbrojtjes civile shqiptare, rrugëtimi profesional i z. Haki Çako përfaqëson një ndër karrierat më të spikatura në fushën e sigurisë publike në Shqipëri...

faqe 6

TAKIME TË NIVELIT TË LARTË NË PENTAGON DHE DEPARTAMENTIN AMERIKAN TË SHTETIT

Ministri Ermal Nufi në SHBA: Partneriteti strategjik me Shtetet e Bashkuara, gur themeli i sigurisë dhe modernizimit të mbrojtjes

Uashington, SHBA – Vizita zyrtare e ministrit të Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, z. Ermal Nufi, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shënoi një etapë të rëndësishme në forcimin e marrëdhënieve strategjike shqiptaro-amerikane në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Përgjatë qëndrimit në Uashington, ministri Nufi zhvilloi një sërë takimesh të nivelit të lartë në Pentagon, Departamentin Amerikan të Shtetit dhe Agjencinë e Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), ku në fokus të diskutimeve ishte avancimi i bashkëpunimit dypalësh, modernizimi i Forcave të Armatosura dhe rritja e kontributit të Shqipërisë në kuadër të NATO-s.

Një nga momentet më të rëndësishme të vizitës ishte pjesëmarrja në Takimet Dypalëshe për Konsultimet e Mbrojtjes, të zhvilluara më 11 dhe 12 qershor, në Pentagon. Delegacioni amerikan u kryesua nga Alton Buland, zëvendësndihmës i Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-së dhe përgjegjës për Politikat Evropiane dhe të NATO-s. Gjatë konsultimeve, të dyja palët vlerësuan nivelin e shkëlqyer të bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe SHBA-së, duke nënvizuar nevojën për thellimin e mëtejshëm të partneritetit strategjik në funksion të sigurisë rajonale dhe euro-atlantike. Në qendër të diskutimeve ishte forcimi i kapaciteteve mbrojtëse, modernizimi i Forcave të Armatosura, rritja e ndërveprueshmërisë me forcat aleate dhe mbështetja për projektet strategjike me interes të përbashkët.

Ministri Nufi theksoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar ndaj këtij partneriteti të veçantë dhe është krenare për kontributin e saj në rritje në kuadër të marrëdhënieve me SHBA-në.

“Ne jemi krenarë për angazhimin dhe kontributin në rritje të Shqipërisë në kuadër të këtij partneriteti strategjik dhe mezi presim të thellojmë më tej miqësinë dhe bashkëpunimin tonë”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes.

SHBA, partneri më strategjik i Shqipërisë

Gjatë takimeve në Pentagon, ministri Nufi vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme që Shtetet e Bashkuara i kanë dhënë Shqipërisë ndër vite, duke e konsideruar atë si një element kyç në zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

“Shqipëria vlerëson thellësisht mbështetjen e vazhdueshme dhe afatgjatë të SHBA-së dhe të qytetarëve të saj. Ne do të jemi gjithmonë mirënjohës për mbështetjen e jashtëzakonshme dhe veprimet që SHBA-të kanë ndërmarrë në mbështetje të Shqipërisë gjatë gjithë historisë sonë. Është e qartë se SHBA-të do të mbeten partneri më strategjik i Shqipërisë dhe mbështetja juaj është thelbësore për ne në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes”, - deklaroi ministri Nufi.

Kjo deklaratë pasqyron qartë rëndësinë që marrëdhëniet me Shtetet e Bashkuara zënë në politikën e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit tonë, si dhe vullnetin për të zgjeruar bashkëpunimin në fusha me interes të përbashkët.

Bisedimet u fokusuan në zhvillimet e sigurisë në rajon, forcimin e bashkëpunimit në kuadër të NATO-s dhe identifikimin e mundësive të reja për avancimin e marrëdhënieve dypalëshe në fushën e mbrojtjes. Në një reagim publik pas takimeve, ministri Nufi i cilësoi diskutimet si konstruktive dhe me rëndësi të veçantë për të ardhmen e bashkëpunimit mes dy vendeve.



“Çojmë përpara bashkëpunimin në Aleancën e NATO-s dhe mundësitë e reja për avancimin e marrëdhënieve tona dypalëshe në fushën e mbrojtjes”, - theksoi ai.

Fokus te modernizimi i Forcave të Armatosura

Një tjetër ndalesë e rëndësishme e ministrit Nufi ishte takimi me drejtoreshën në detyrë të Agjencisë së Bashkëpunimit për Sigurinë e Mbrojtjes (DSCA), Mary Beth Morgan.

Gjatë këtij takimi u diskutua mbi avancimin e projekteve të përbashkëta që lidhen me modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, rritjen e kapaciteteve operationale dhe mbështetjen amerikane në proceset e transformimit të sektorit të mbrojtjes.

Ministri Nufi theksoi se bashkëpunimi me SHBA-në mbetet një faktor vendimtar për zhvillimin e kapaciteteve moderne ushtarake të vendit.

“Bashkëpunimi ynë strategjik me SHBA-të mbetet një shtyllë e rëndësishme për modernizimin e Forcave



të Armatosura të Shqipërisë, rritjen e kapaciteteve tona mbrojtëse dhe forcimin e kontributit të vendit tonë në kuadër të Aleancës brenda NATO-s”, - deklaroi ai.

Partneritet për sigurinë e përbashkët

Vizita e ministrit Ermal Nufi në Shtetet e Bashkuara konfirmoi edhe një herë nivelin e lartë të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane dhe vullnetin e përbashkët për ta çuar më tej këtë partneritet strategjik.

Në një kohë kur mjedisi global i sigurisë po përballet me sfida të reja dhe kërcënime në zhvillim, bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe SHBA-së mbetet një garanci e rëndësishme për forcimin e kapaciteteve mbrojtëse, sigurinë rajonale dhe kontributin e përbashkët në kuadër të NATO-s.

Takimet e zhvilluara në Pentagon, Departamentin e Shtetit dhe DSCA dëshmojnë qartë se marrëdhëniet mes dy vendeve vazhdojnë të jenë më të forta se kurrë, të bazuara mbi besimin reciprok, vlerat e përbashkëta demokratike dhe objektivat strategjike për paqen, sigurinë dhe stabilitetin.



SHQIPËRIA RIAFIRMON ANGAZHIMIN NË NATO

Ministri Ermal Nufi në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes në Bruksel: Aleatë të bashkuar për një siguri më të fortë

Në një kohë kur mjedisi i sigurisë globale po përballët me sfida gjithnjë e më komplekse, Aleanca e Atlantikut të Veriut vijon të mbetet shtylla kryesore e mbrojtjes kolektive dhe stabilitetit euro-atlantik. Në këtë kuadër, Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Shqipërisë, **Ermal Nufi**, mori pjesë në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, të zhvilluar në Bruksel, ku u diskutuan prioritetet strategjike të Aleancës dhe masat për forcimin e sigurisë së përbashkët.

Takimi mbledhi ministrat e mbrojtjes të 32 vendeve aleate në një moment të rëndësishëm për NATO-n, ndërsa vëmendja është përqendruar te rritja e gatishmërisë operacionale, forcimi i kapaciteteve mbrojtëse dhe përbashkimi i kërcënimeve që po evoluojnë në dimensione të ndryshme të sigurisë ndërkombëtare.

Gjatë diskutimeve, aleatët theksuan nevojën për ruajtjen e unitetit dhe kohezionit brenda Aleancës, si elemente themelore për garantimin e sigurisë kolektive. Po ashtu, u vu theksi te investimet në mbrojtje, modernizimi i forcave të armatosura dhe rritja e aftësive për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive sfidave të së tashmes dhe të së ardhmes.

Në këtë forum të nivelit të lartë, ministri i Mbrojtjes, Ermal Nufi, riafirmoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë ndaj NATO-s dhe objektivave të saj strategjike, duke nënvizuar se vendi ynë mbetet një aleat aktiv dhe i besueshëm në përbushjen e detyrimeve që burojnë nga anëtarësimi në Aleancë.

Pas përfundimit të takimit, ministri Nufi theksoi rëndësinë e bashkëpunimit mes vendeve aleate dhe domosdoshmërinë e investimeve të vazhdueshme në fushën e mbrojtjes.

“Bashkëpunimi ndërmjet aleatëve, investimet në mbrojtje dhe modernizimi i kapaciteteve ushtarake janë garancia më e fortë për paqen, sigurinë dhe mbrojtjen e vlerave tona të përbashkëta”, - u shpreh ministri Nufi.

Duke vlerësuar rolin e NATO-s si organizata më e suksesshme e sigurisë kolektive në botë, ai theksoi se Shqipëria do të vazhdojë të kontribuojë me përgjegjësi dhe vendosmëri në të gjitha nismat dhe aktivitetet e Aleancës.

“Shqipëria do të vijojë të japë kontributin e saj të pandërprerë me përgjegjësi dhe vendosmëri në kuadër të NATO-s, si një aleatë e përkushtuar dhe e besueshme, duke forcuar rolin e saj si faktor stabiliteti në rajon e më gjerë”, - deklaroi Ministri i Mbrojtjes.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë takim të rëndësishëm pasqyron jo vetëm angazhimin e vendit tonë në strukturat euro-atlantike, por edhe rolin gjithnjë e më aktiv të Forcave të Armatosura shqiptare në misionet, operacionet dhe iniciativat e NATO-s.



Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të modernizimit të kapaciteteve ushtarake, rritjes së ndërveprueshmërisë me forcat aleate dhe përbushjes së objektivave të Aleancës për forcimin e mbrojtjes dhe sigurisë kolektive. Këto përpjekje janë vlerësuar vazhdimisht nga partnerët dhe aleatët, duke e pozicionuar vendin tonë si një kontribuues të rëndësishëm në arkitekturën e sigurisë euro-atlantike.

Takimi i Ministrave të Mbrojtjes në Bruksel shërbeu



githashtu si një mundësi për të diskutuar mbi zhvillimet e fundit të sigurisë, forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes së NATO-s dhe koordinimin e veprimeve të përbashkëta përballë sfidave që prekin sigurinë globale.

Në një mjedis ndërkombëtar të karakterizuar nga pasiguri dhe dinamika të reja gjeopolitike, Shqipëria mbetet e vendosur të qëndrojë krah aleatëve të saj, duke kontribuar aktivisht në ruajtjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe në të gjithë hapësirën euro-atlantike.

Shqipëria merr stafetën e stërvitjes rajonale “ADRION 27”

Forcat Detare Shqiptare do të mirëpresin dhe drejojnë edicionin e ardhshëm të një prej aktiviteteve më të rëndësishme të bashkëpunimit detar në rajonin e Adriatikut dhe Jonit

Në Portin e Durrësit u zhvillua ceremonia zyrtare e dorëzimit të komandës dhe përgjegjësisë së vendit pritës të stërvitjes rajonale “ADRION”, nga Forcat Detare të Sllovenisë te Forca Detare e Republikës së Shqipërisë.

Ceremonia u organizua pas përfundimit me sukses të stërvitjes shumëkombëshe “**ADRION 26**”, e cila u zhvillua gjatë një jave në ujërat dhe portet e Republikës së Sllovenisë, me pjesëmarrjen e forcave detare të vendeve anëtare të nismës ADRION.

Me marrjen e kësaj përgjegjësie, Shqipëria nis përgatitjet për organizimin dhe drejtimin e stërvitjes “**ADRION 27**”, duke konfirmuar angazhimin e saj të vazhdueshëm për forcimin e bashkëpunimit rajonal, sigurisë detare dhe ndërveprueshmërisë ndërmjet forcave detare të vendeve pjesëmarrëse.

Gjatë ceremonisë u vlerësua kontributi i Forcave Detare Sllovene në organizimin e suksesshëm të edicionit të fundit të stërvitjes, si dhe u shpreh besimi se Forca Detare Shqiptare do të vijojë me profesionalizëm traditën e kësaj nisme të rëndësishme rajonale.

Stërvitja “ADRION” përfaqëson një nga platformat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak detar në rajonin e Adriatikut dhe Jonit, duke synuar rritjen e kapaciteteve operacionale, shkëmbimin e eksperiencave dhe forcimin e koordinimit ndërmjet marinave të vendeve pjesëmarrëse.

Nëpërmjet aktiviteteve të përbashkëta, stërvitja kontribuon në garantimin e sigurisë detare, mbrojtjen e interesave të përbashkëta në hapësirën detare, si dhe në promovimin e lirisë së lundrimit dhe stabilitetit rajonal.

Marrja e stafetës nga Shqipëria për organizimin e “ADRION 27” përbën një vlerësim për profesionalizmin dhe



kapacitetet e Forcës Detare Shqiptare, si dhe një mundësi për të forcuar më tej rolin e vendit tonë në nismat rajonale të sigurisë dhe bashkëpunimit detar. Forca Detare e Republikës së Shqipërisë mbetet e angazhuar në zhvillimin e



partneriteteve rajonale dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen e sigurisë në Adriatik dhe Jon, si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta për paqen, stabilitetin dhe bashkëpunimin mes vendeve të rajonit.

Gjeneralletënant Arben Kingji merr pjesë në Simpoziumin e NATO-s për Goditjen me Precizion në Thellësi

Mons, Belgjikë – Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Gjeneralletënant **Arben Kingji**, mori pjesë në Simpoziumin e Goditjes me Precizion në Thellësi (Deep Precision Strike – DPS), i zhvilluar në selinë e Komandës Supreme Aleate të NATO-s (SHAPE), në Mons të Belgjikës.

Ky simpozium mbledhi drejtues të lartë ushtarakë, ekspertë të planifikimit strategjik dhe përfaqësues të vendeve aleate, për të diskutuar mbi zhvillimin e kapaciteteve të Goditjes me Precizion në Thellësi, një nga komponentët më të rëndësishëm për garantimin e epërsisë operationale të NATO-s, në mjedisin e sotëm dhe të ardhshëm të sigurisë.

Gjatë punimeve të simpoziut, Gjeneralletënant Arben Kingji theksoi rëndësinë strategjike të këtyre kapaciteteve për forcimin e aftësive parandaluese dhe mbrojtëse të Aleancës, në një periudhë kur sfidat e sigurisë po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe të paparashikueshme.

Në fjalën e tij, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm nënvizoi se Goditja me Precizion në Thellësi përbën një element kyç për ruajtjen e epërsisë ushtarake të NATO-s dhe për rritjen e efektivitetit të operationeve të saj në të gjitha dimensionet e veprimit.

“Shqipëria mbështet plotësisht zhvillimin dhe avancimin e kapaciteteve të Goditjes me Precizion në Thellësi, si një domosdoshmëri për ruajtjen e epërsisë së Aleancës në mjedisin aktual dhe të ardhshëm të sigurisë. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten të angazhuara për të kontribuar në përpjekjet e përbashkëta të NATO-s dhe për të fuqizuar funksionet mbështetëse të vendit tonë, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në suksesin e operationeve aleate”, - theksoi gjeneralletënant Kingji. Gjeneralletënant Kingji vuri në dukje gjithashtu rëndësinë e investimeve në infrastrukturën mbështetëse, rritjen e ndërveprueshmërisë me vendet aleate dhe zhvillimin e kapaciteteve kombëtare që mundësojnë mbështetjen efektive të operationeve dhe aktiviteteve të NATO-s në rajon. Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë forum të nivelit të lartë dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të



vendit tonë në strukturat e Aleancës dhe rolin aktiv që Forcat e Armatosura shqiptare luajnë në forcimin e sigurisë kolektive euroatlantike.

Simpoziumi i Goditjes me Precizion në Thellësi shërbeu si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave, diskutimin e koncepteve të reja operationale dhe identifikimin e sfidave që lidhen me zhvillimin e teknologjive dhe kapaciteteve të avancuara ushtarake, të cilat do të ndikojnë në mënyrën e zhvillimit të operationeve të NATO-s në të ardhmen.

Përmes pjesëmarrjes aktive në iniciativa të tilla strategjike, Shqipëria vijon të konsolidojë pozicionin e saj si një aleat i besueshëm dhe kontribuues i rëndësishëm në misionin e përbashkët për paqen, sigurinë dhe stabilitetin në hapësirën euroatlantike.

Niset drejt Kosovës Kontingjenti KFOR 8 i Forcës Tokësore

Efektivët shqiptarë do të shërbejnë në misionin e NATO-s për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë

Në ambientet e Regjimentit të Këmbësisë së Jugut në Poshnjë u zhvillua ceremonia e përcjelljes së Kontingjentit **KFOR 8**, i cili do të dislokohe në Pejë, në kuadër të misionit të NATO-s, në Kosovë.

Ceremonia u zhvillua në prani të drejtuesve dhe personelit ushtarak, të cilët përcollën urimet dhe vlerësimet për efektivët që do të përfaqësojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në një prej misioneve më të rëndësishme të Aleancës në rajon.

Me profesionalizëm, përkushtim dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie, efektivët e Forcës Tokësore nisin misionin e tyre në mbështetje të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në Kosovë, duke kontribuar në përmbushjen e objektivave të misionit të NATO-s për garantimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët.

Kontingjenti KFOR 8 përbëhet nga ushtarakë të trajnuar dhe të përgatitur sipas standardeve të NATO-s, të cilët do të kryejnë detyrat e tyre në bashkëpunim të ngushtë me forcat aleate të dislokuara në Kosovë.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura shqiptare në misionin KFOR është një dëshmi konkrete e angazhimit të Shqipërisë ndaj sigurisë rajonale dhe e rolit aktiv që vendi ynë luan në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Përgjatë viteve, kontingjentet shqiptare kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në operationet ndërkombëtare të paqes dhe sigurisë, duke fituar vlerësimin e partnerëve dhe aleatëve për profesionalizmin, disiplinën dhe përkushtimin në përmbushjen e detyrave.

Në ceremoninë e nisjes u theksua se misioni në Kosovë mbetet një angazhim me rëndësi të



veçantë për Shqipërinë, jo vetëm si vend anëtar i NATO-s, por edhe si një faktor aktiv në promovimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Përkrah aleatëve të NATO-s, Forca Tokësore vijon të japë kontribut të çmuar në operationet ndërkombëtare, duke dëshmuar gatishmëri të lartë operationale, profesionalizëm dhe përkushtim në shërbim të paqes dhe sigurisë.

Efektivëve të Kontingjentit KFOR 8, u uruan suksese në përmbushjen e misionit, mbarësi gjatë shërbimit në Kosovë dhe kthim të sigurt pranë familjeve dhe atdheut.



Qendra që ndryshon jetët: Mbështetje, terapi dhe shpresë për fëmijët e ushtarakëve me çrregullime të spektrit të autizmit

Në zemër të komunitetit ushtarak shqiptar, prej më shumë se një dekade funksionon një nga nismat më humane dhe më të rëndësishme sociale të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes në mbështetje të familjeve të Forcave të Armatosura. Bëhet fjalë për Qendrën e Trajtitit Terapeutik dhe Edukimit për fëmijët e personelit ushtarak me çrregullime të spektrit të autizmit dhe probleme të tjera zhvillimore, e ngritur në mjediset e Batalionit të Mbështetjes Rajonale në Tufinë, Tiranë.

E themeluar në nëntor të vitit 2015, kjo qendër është kthyer në një strehë shprese për dhjetëra familje ushtarake, duke ofruar shërbime të specializuara terapeutike, psikologjike dhe sociale për fëmijët që përballen me sfida të zhvillimit, si dhe mbështetje të vazhdueshme për prindërit e tyre.

Një mision që shkon përtej detyrës

Jeta ushtarake shoqërohet shpesh me sakrifica të shumta. Përveç angazhimeve profesionale dhe misioneve në shërbim të vendit, shumë ushtarakë përballen edhe me sfidat e rritjes dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta. Pikërisht për këtë arsye, Ministria e Mbrojtjes ndërmori nismën për krijimin e një strukture të dedikuar, ku familjet të mund të gjenin ndihmën profesionale që u nevojitet, pa u rënduar nga kostot e larta financiare dhe ngarkesa emocionale që shpesh shoqërojnë trajtimet afatgjata.

Kjo qendër përfaqëson një model konkret të kujdesit institucional ndaj personelit ushtarak dhe familjeve të tyre, duke dëshmuar se mbështetja për ushtarakun nuk kufizohet vetëm te detyra dhe karriera, por shtrihet edhe te mirëqenia e familjes së tij.

Shërbime të specializuara për zhvillimin e fëmijëve

Në qendër ofrohet një gamë e gjerë shërbimesh psiko-sociale për fëmijët me çrregullime të spektrit autik, çrregullime të të nxënit, çrregullime të vëmendjes dhe hiperaktivitetit, si dhe probleme të tjera zhvillimore.

Procesi nis me vlerësimin psikologjik të fushave të zhvillimit të fëmijës, i cili shërben si bazë për hartimin e programeve individuale terapeutike. Më pas vijon puna intensive përmes terapisë individuale, duke përfshirë terapi zhvillimi dhe terapi ABA (Applied Behavior Analysis), një nga metodat më të njohura dhe të suksesshme në nivel ndërkombëtar për trajtimin e fëmijëve me autizëm.

Këto trajtim synojnë përmirësimin e komunikimit, zhvillimin e aftësive njohëse, rritjen e autonomisë personale dhe ndërtimin e sjelljeve funksionale që ndihmojnë fëmijën të integrohet më mirë në jetën e përditshme.

Një rol të rëndësishëm zënë edhe terapitë në grup, ku fëmijët mësojnë të ndërveprojnë me bashkëmoshatarët, të zhvillojnë aftësi sociale, të pranojnë ndryshimet, të bashkëpunojnë dhe të ndërtojnë marrëdhënie më të qëndrueshme me të tjerët.

Edukim përmes lojës dhe aktivitetit fizik

Për specialistët e qendrës, zhvillimi i fëmijës nuk kufizohet vetëm në sallat e terapisë. Për këtë arsye, në programet e përditshme përfshihen aktivitete motorike dhe argëtuese, të organizuara në palestrën e qendrës dhe në ambientet e jashtme.

Këto aktivitete ndihmojnë në përmirësimin e koordinimit fizik, zhvillimin e aftësive motorike, nxitjen e pavarësisë personale dhe promovimin e një jetese të shëndetshme. Përmes lojës dhe aktiviteteve të strukturuar, fëmijët fitojnë vetëbesim dhe krijojnë lidhje më të forta me mjedisin që i rrethon.

Një element i veçantë është edhe kuzhina didaktike e qendrës, ku fëmijët mësojnë aftësi bazë të jetës së përditshme, duke zhvilluar autonominë dhe pavarësinë në kryerjen e veprimeve të zakonshme.

Mbështetje edhe për prindërit

Në filozofinë e punës së qendrës, suksesi i trajtimit të fëmijës është i lidhur ngushtë me përfshirjen aktive të familjes. Për këtë arsye, prindërit përfitojnë shërbime të specializuara psiko-sociale dhe këshillimore.

Përmes vlerësimit të nevojave dhe mbështetjes së vazhdueshme, specialistët ndihmojnë prindërit të kuptojnë më mirë sfidat me të cilat përballlet fëmija i tyre, të zhvillojnë strategji efektive komunikimi dhe të përballojnë më lehtë ngarkesën emocionale që shpesh shoqëron këto situata.

Qasja kognitivo-bihejviorale e përdorur nga specialistët ka rezultuar një instrument i rëndësishëm në fuqizimin e familjeve dhe në krijimin e një mjedisi më mbështetës për zhvillimin e fëmijëve.

Bashkëpunim me shkollat dhe institucionet

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i punës së qendrës është bashkëpunimi i vazhdueshëm me institucionet arsimore që



frekuentojnë fëmijët.

Psikologët dhe terapistët ndërveprojnë me kopshtet dhe shkollat për të ndjekur progresin e fëmijëve dhe për të koordinuar strategjitë edukative që ndihmojnë në tejkalimin e vështirësive specifike. Ky bashkëpunim krijon një qasje të integruar dhe siguron vazhdimësi në procesin e zhvillimit të fëmijës. Po ashtu, qendra ruan kontakte të vazhdueshme me institucione dhe organizata profesionale që aplikojnë metoda bashkëkohore terapeutike, duke mundësuar rritjen profesionale të stafit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimeve.

Profesionalizëm dhe përkushtim

Në qendër punojnë tre psikologë të licencuar, të trajnuar në metodologjinë ABA dhe me mbi 10 vite eksperiencë në fushën e psikologjisë dhe punës me fëmijët.

Eksperienca, profesionalizmi dhe përkushtimi i tyre përbëjnë shtyllën kryesore të suksesit të kësaj strukture. Çdo fëmijë trajtohet sipas nevojave individuale, ndërsa progresi monitorohet në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar rezultate sa më të mira.

Ambientet e qendrës janë të projektuara për t'iu përgjigjur nevojave specifike të fëmijëve: dy klasa për terapi individuale dhe në grup, palestër për aktivitete motorike, kuzhinë funksionale për zhvillimin e autonomisë dhe një hapësirë e

jashtme e qetë e përshtatshme për aktivitete në natyrë.

Një investim në të ardhmen

Qendra e Trajtitit Terapeutik dhe Edukimit, në Tufinë, është shumë më tepër sesa një strukturë shërbimi social. Ajo përfaqëson një investim të drejtpërdrejtë në mirëqenien e familjeve ushtarake dhe në të ardhmen e fëmijëve që kanë nevojë për mbështetje të specializuar.

Në një kohë kur ndërgjegjësimi për çrregullimet e spektrit të autizmit po rritet vazhdimisht, ekzistenca e një qendre të tillë brenda sistemit të mbrojtjes është dëshmi e përgjegjësisë sociale dhe e kujdesit institucional ndaj njerëzve që i shërbejnë vendit.

Për shumë prindër ushtarakë, kjo qendër nuk është vetëm një vend trajtimi. Ajo është një burim shprese, mbështetjeje dhe besimi se fëmijët e tyre mund të zhvillojnë potencialin e plotë dhe të ndërtojnë një të ardhme më të mirë.

Në fund të fundit, forca e një ushtrie matet jo vetëm nga aftësitë e saj operacionale, por edhe nga kujdesi që tregon për njerëzit e saj. Dhe kjo qendër është një shembull i qartë se Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten të përkushtuara jo vetëm ndaj mbrojtjes së vendit, por edhe ndaj mbrojtjes së familjeve që qëndrojnë pas çdo ushtaraku.



Intervistoi: **ANJEZA MUSOLLARI,**
Shefe e Sektorit të Botimeve

Nga strukturat e hetimit të krimit dhe drejtimi i Policisë së Shtetit, deri te ndërtimi i sistemit modern të mbrojtjes civile shqiptare, rrugëtimi profesional i z. Haki Çako përfaqëson një ndër karrierat më të spikatura në fushën e sigurisë publike në Shqipëri. Me mbi tre dekada përvojë në pozicione drejtuese të Policisë së Shtetit dhe prej vitit 2019 në krye të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, ai ka qenë një nga protagonistët kryesorë të reformimit të sistemit kombëtar të menaxhimit të emergjencave. Nën drejtimin e tij u konsolidua Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, u përforcua kuadri ligjor përmes ligjit “Për Mbrojtjen Civile” dhe Shqipëria u anëtarësua në Mekanizmin e Bashkimit Europian për Mbrojtjen Civile.

Në këtë intervistë për gazetën “Ushtria”, **Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako**, flet për sfidat e menaxhimit të emergjencave në një kohë kur ndryshimet klimatike po rrisin frekuencën e fatkeqësive natyrore, për bashkëpunimin me Forcat e Armatosura dhe partnerët ndërkombëtarë, si dhe për vizionin e tij mbi të ardhmen e mbrojtjes civile në Shqipëri.

Zoti Çako, pas një karriere të gjatë në Policinë e Shtetit, çfarë ju motivoi të angazhoheni në fushën e mbrojtjes civile?

Kam patur një karrierë të gjatë në strukturat e Policisë së Shtetit, ku kam shërbyer kryesisht në hetimin e krimeve dhe në pozicione drejtuese të rëndësishme. Gjatë gjithë karrierës sime jam udhëhequr nga parimet e ndershmërisë, integritetit dhe profesionalizmit, duke e konsideruar shërbimin ndaj qytetarëve si detyrimin më të lartë.

Pas përfundimit të detyrës si Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, angazhimi në fushën e mbrojtjes civile erdhi si një vazhdimësi natyrale e misionit tim në shërbim të sigurisë publike.

Nëse Policia e Shtetit mbron qytetarët nga kërcënimet që vijnë nga veprimtaria kriminale, mbrojtja civile synon mbrojtjen e jetës, pronës, mjedisit dhe komuniteteve nga fatkeqësitë natyrore apo ato të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Në thelb, objektivi mbetet i njëjtë: mbrojtja e qytetarëve dhe rritja e sigurisë së tyre.

Si e vlerësoni rrugëtimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile që nga krijimi i saj deri më sot?

Rrugëtimi i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile mund të vlerësohet si një proces i rëndësishëm reformimi dhe konsolidimi institucional.

Krijimi i AKMC-së dhe hyrja në fuqi e Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, shënuan kalimin nga një qasje kryesisht reaguese drejt një sistemi modern të bazuar në parandalim, përgatitje, reagim dhe rimëkëmbje.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar bazat ligjore dhe institucionale të sistemit kombëtar të mbrojtjes civile, janë forcuar mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional dhe është rritur bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe partnerët ndërkombëtarë.

Një arritje e rëndësishme ka qenë anëtarësimi i Shqipërisë në Mekanizmin Europian të Mbrojtjes Civile, duke e bërë vendin pjesë të një rrjeti të gjerë solidariteti dhe bashkëpunimi europian.

Sot AKMC është institucioni qendror koordinues i sistemit të mbrojtjes civile dhe vazhdon të punojë për forcimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet.

Cilat kanë qenë momentet më sfiduese që keni përjetuar në drejtimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes civile?

Sistemi i mbrojtjes civile përballet vazhdimisht me sfida të ndryshme, por momentet më të vështira janë ato kur emergjencat prekin njëkohësisht një numër të madh qytetarësh, infrastrukturën dhe aktivitetin ekonomik.

Ndër sfidat më të mëdha kanë qenë menaxhimi i sezoneve intensive të zjarreve në vitet e fundit, përmbytjet në zona të ndryshme të vendit, si dhe situatat që kanë kërkuar koordinimin në kohë reale të shumë institucioneve dhe strukturave operacionale.

Këto situata kanë testuar kapacitetet e sistemit, por njëkohësisht kanë treguar rëndësinë e koordinimit ndërinstitucional, gatishmërisë operacionale dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë. Çdo emergjencë ka sjellë mësim të vlefshme që kanë ndihmuar në forcimin e sistemit tonë të mbrojtjes civile

Tërmeti i 26 nëntorit 2019, ishte një provë historike për vendin. Çfarë mësimesh nxori Shqipëria nga ajo emergjencë?

Tërmeti i 26 nëntorit 2019, përbën një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë moderne të mbrojtjes civile në Shqipëri. Ai evidentoi nevojën për një reformë të thellë të sistemit dhe për një qasje të re në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë.

Një nga mësimet kryesore ishte se sistemi nuk mund të mbështetet vetëm te reagimi pas ngjarjes, por duhet të investojë vazhdimisht në parandalim, planifikim, edukim, ndërgjegjësim dhe forcim kapacitetesh.

Pas tërmetit u përshpejtua zbatimi i Ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, u forcua roli koordinues i AKMC-së, u hartuan dokumente strategjike si Vlerësimi Kombëtar i Riskut, Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani Kombëtar i Emergjencave Civile.

Në Vijën e Parë të Sigurisë Kombëtare, Mbrojtja Civile përballë Sfidave të Shekullit XXI

HAKI ÇAKO: Mbrojtja civile nuk është vetëm reagim ndaj emergjencave, por kulturë kombëtare e sigurisë



Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako

Gjithashtu u kuptua qartë rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar, koordinimit ndërinstitucional dhe përfshirjes së komuniteteve në përgatitjen ndaj emergjencave.

Sa ka ndryshuar sot gatishmëria e institucioneve për t’u përballur me fatkeqësi natyrore?

Gatishmëria e institucioneve ka njohur përmirësime të konsiderueshme pas reformës së mbrojtjes civile të vitit 2019. Sot ekzistojnë mekanizma më të qartë koordinimi ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore, plane emergjence në nivele të ndryshme të sistemit dhe procedura të standardizuara reagimi.

Është forcuar roli i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, janë rritur kapacitetet e bashkive dhe prefekturave, ndërsa ushtrimet dhe trajnimet e përbashkëta kanë ndikuar në rritjen e gatishmërisë operacionale.

Megjithëse mbeten sfida për t’u adresuar, sistemi sot është më i organizuar, më i koordinuar dhe më i aftë për t’u përballur me situata emergjente komplekse.

Shqipëria po përballet gjithnjë e më shpesh me përmbytje, zjarre dhe fenomene ekstreme klimatike. Sa i rrezikuar është vendi ynë nga ndryshimet klimatike?

Shqipëria konsiderohet një nga vendet e ekspozuara ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike për shkak të pozicionit gjeografik dhe karakteristikave të saj natyrore.

Në vitet e fundit kemi vërejtur rritje të temperaturave ekstreme, periudha më të gjata thatësire, përmbytje më intensive dhe rritje të rrezikut nga zjarret në pyje.

Këto fenomene ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e komuniteteve, ekonominë, bujqësinë, burimet ujore dhe infrastrukturën kritike.

Për këtë arsye, ndryshimet klimatike përbëjnë një sfidë serioze për sistemin e mbrojtjes civile.

Përgjigjja ndaj kësaj sfide kërkon investime në masa parandaluese, sisteme të paralajmërimit të hershëm, planifikim të bazuar në risk dhe rritje të reziliencës së komuniteteve ndaj rreziqeve të ardhshme.

Cilat janë rreziqet kryesore që identifikohen në Vlerësimin Kombëtar të Riskut nga Fatkeqësitë?

Bazuar në Vlerësimin Kombëtar të Riskut nga Fatkeqësive, risqet më kritike për vendin janë identifikuar përmbytjet, rreziqet biologjike, rreziqet teknologjike, çarja e digave, rrëshqitjet e tokës dhe tërmetet.

Këto rreziqe janë vlerësuar mbi bazën e probabilitetit të ndodhjes dhe ndikimit të mundshëm që mund të kenë mbi popullsinë, ekonominë, mjedisin dhe infrastrukturën kritike të vendit.

Vlerësimi Kombëtar i Riskut shërben si dokument bazë për planifikimin strategjik, investimet në parandalim dhe zhvillimin e politikave kombëtare për reduktimin e riskut nga fatkeqësitë.

Si funksionon koordinimi ndërinstitucional gjatë një emergjence kombëtare?

Koordinimi ndërinstitucional është një nga shtyllat kryesore të sistemit të mbrojtjes civile. Sipas Ligjit nr. 45/2019, emergjenca menaxhohet fillimisht në nivel vendor nga bashkitë dhe strukturat lokale. Kur kapacitetet vendore nuk janë të mjaftueshme, aktivizohet niveli i qarkut përmes prefektit dhe, në rast nevojë, mbështetja kombëtare përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Në situata të fatkeqësive me ndikim të gjerë, koordinimi realizohet edhe përmes Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile.

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile luan rol kyç në monitorimin e situatës, shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve ndërmjet të gjitha institucioneve pjesëmarrëse.

Çfarë roli luajnë Forcat e Armatosura në sistemin e mbrojtjes civile?

Forcat e Armatosura janë një komponent shumë i rëndësishëm i sistemit kombëtar të mbrojtjes civile. Ato ofrojnë kapacitete operacionale, logjistike dhe teknike për përballimin e emergjencave civile, veçanërisht në rastet kur kapacitetet civile janë të pamjaftueshme. Njësitë e Forcave të Armatosura angazhohen në operacione kërkim-shpëtimi, evakuimi, transporti, mbështetje logjistike, përballim përmbytjesh, zjarresh dhe situatash të tjera emergjente. Bashkëpunimi ndërmjet AKMC-së dhe Forcave të Armatosura është i vazhdueshëm dhe përbën një element kyç për garantimin e një reagimi të koordinuar dhe efektiv në raste fatkeqësish.

Si e vlerësoni bashkëpunimin mes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Ministrisë së Mbrojtjes?

Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile është shumë i ngushtë dhe strategjik. Të dy institucionet punojnë në mënyrë të koordinuar për forcimin e sistemit kombëtar të mbrojtjes civile, rritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e kapaciteteve të reagimit ndaj emergjencave. Sipas ligjit nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, Ministri i Mbrojtjes, si ministri përgjegjës për mbrojtjen civile, ka një rol thelbësor dhe qendror në drejtimin e të gjithë sistemit të mbrojtjes civile në Republikën e Shqipërisë.

Ai përcakton politikat dhe prioritetet strategjike, siguron koordinimin ndërinstitucional në nivel kombëtar dhe garanton funksionimin e integruar të të gjitha strukturave të përfshira në parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë. Në këtë kuptim, Ministri i Mbrojtjes është autoriteti kryesor që udhëheq sistemin e mbrojtjes civile dhe siguron vendimmarrjen dhe drejtimin e unifikuar në situata emergjente.

Cilat janë kapacitetet aktuale të vendit për reagimin ndaj emergjencave të mëdha?

Shqipëria disponon sot një sistem më të organizuar dhe më të koordinuar për reagimin ndaj emergjencave civile. Në këtë sistem përfshihen strukturat e mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, shërbimet e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimt, Policia e Shtetit, Forcat e Armatosura, urgjenca mjekësore, ekipet e kërkim-shpëtimt dhe institucionet teknike monitoruese. Koordinimi realizohet përmes Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, ndërsa planet e emergjencave civile në të gjitha nivelet sigurojnë një reagim të organizuar dhe të integruar.

Një mbështetje e rëndësishme vjen edhe nga partnerët ndërkombëtarë dhe Mekanizmi Europian i Mbrojtjes Civile. Megjithatë, forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve operacionale, teknologjike dhe logjistike mbetet një prioritet i vazhdueshëm.

Sa i rëndësishëm është anëtarësimi i Shqipërisë në Mekanizmin Europian të Mbrojtjes Civile?

Anëtarësimi i Shqipërisë në Mekanizmin Europian të Mbrojtjes Civile është një arritje strategjike për vendin. Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota më 18 nëntor 2022, duke u integruar plotësisht në sistemin europian të bashkëpunimit për menaxhimin e fatkeqësive. Ky mekanizëm bazohet në solidaritetin dhe mbështetjen reciproke ndërmjet vendeve pjesëmarrëse. Në rast fatkeqësish të mëdha, Shqipëria mund të kërkojë dhe të marrë ndihmë të specializuar nga vendet partnere, por njëkohësisht ka mundësinë të kontribuojë në operacionet ndërkombëtare të ndihmës. Anëtarësimi ka rritur kapacitetet tona të reagimit, ka përmirësuar koordinimin ndërkombëtar dhe ka krijuar mundësi të reja për trajnim, shkëmbim përvojash dhe zhvillim të kapaciteteve kombëtare.



Çfarë përfitimesh konkrete ka sjellë ky anëtarësim për qytetarët shqiptarë?

Përfitimet janë konkrete dhe të drejtpërdrejta për qytetarët shqiptarë. Përmes Mekanizmit European të Mbrojtjes Civile, Shqipëria ka akses më të shpejtë në kapacitete ndërkombëtare të reagimit në rastet e fatkeqësive të mëdha, duke përfshirë ekipe kërkim-shpëtimi, mjete teknike, ekspertë dhe asistencë humanitare. Gjithashtu, institucionet shqiptare përfitojnë nga programe trajnimi, ushtrime ndërkombëtare, shkëmbim ekspertize dhe projekte që forcojnë sistemin kombëtar të mbrojtjes civile.

Për qytetarët, kjo përkthehet në një reagim më të shpejtë dhe më efektiv, mbrojtje më të mirë të jetës, pronës dhe mjedisit, si dhe rritje të sigurisë së komuniteteve përballë rreziqeve natyrore dhe atyre të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore.

Shqipëria ka marrë dhe ka dhënë ndihmë ndërkombëtare në raste emergjencash. Si e vlerësoni këtë dimension të solidaritetit?

Solidariteti ndërkombëtar është një nga shtyllat më të rëndësishme të sistemit modern të mbrojtjes civile. Fatkeqësitë nuk njohin kufij dhe për këtë arsye bashkëpunimi ndërmjet vendeve është thelbësor për mbrojtjen e jetës dhe minimizimin e pasojave. Shqipëria ka përfituar ndihmë të konsiderueshme nga partnerët ndërkombëtarë në momente të vështira, veçanërisht pas tërmetit të vitit 2019 dhe gjatë sezoneve të zjarreve. Nga ana tjetër, vendi ynë ka treguar gatishmëri për të kontribuar në operacione ndërkombëtare, duke dëshmuar se është një partner i përgjegjshëm dhe aktiv. Ky solidaritet forcon besimin, rrit kapacitetet e përbashkëta dhe kontribuon në ndërtimin e një sistemi më të sigurt dhe më efektiv për përballimin e krizave.

Cilat janë marrëdhëniet e AKMC-së me partnerët strategjikë europianë dhe euroatlantikë?

AKMC-ja ka ndërtuar marrëdhënie të forta dhe të qëndrueshme me partnerët strategjikë europianë dhe euroatlantikë. Bashkëpunimi ynë zhvillohet kryesisht përmes Mekanizmit European të Mbrojtjes Civile, Komisionit European, Qendrës së Koordinimit të Reagimit Emergjent (ERCC), NATO-s dhe Qendrës Euro-Atlantike të Koordinimit të Reagimit ndaj Fatkeqësive (EAD RCC).

Gjithashtu, AKMC-ja bashkëpunon ngushtë me organizata ndërkombëtare si UNDP, UNDRR, Banka Botërore dhe me një numër të madh partnerësh dypalësh në rajon dhe më gjerë.

Këto marrëdhënie kontribuojnë në forcimin e kapaciteteve kombëtare, shkëmbimin e eksperiencave, organizimin e ushtrimeve të përbashkëta dhe zhvillimin e projekteve që rrisin reziliencën e vendit ndaj fatkeqësive.

Në çfarë niveli ndodhet sot harmonizimi i sistemit shqiptar me standardet e Bashkimit European?

Sistemi shqiptar i mbrojtjes civile ka bërë progres të konsiderueshëm në harmonizimin me standardet dhe praktikat e Bashkimit European.

Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” është hartuar në përputhje me Kuadrin Sendai dhe përafron një sërë standardesh dhe instrumentesh europiane në këtë fushë. Anëtarësimi në Mekanizmin European të Mbrojtjes Civile ka përsheptuar më tej këtë proces, duke mundësuar pjesëmarrjen në programe trajnimi, ushtrime ndërkombëtare, projekte zhvillimore dhe mekanizma të përbashkët koordinimi. Objektivi ynë mbetet forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe operacionale për të garantuar përputhshmëri të plotë me praktikat më të mira europiane.

Çfarë investimesh janë kryer vitet e fundit për modernizimin e mbrojtjes civile?

Vitet e fundit janë realizuar investime të rëndësishme për modernizimin e sistemit të mbrojtjes civile, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e infrastrukturës operacionale dhe zhvillimin e sistemeve moderne të monitorimit dhe komunikimit. Një ndër projektet më të rëndësishme është ngritja e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm Shumë-Rreziqesh (EAR-MHEWS), i realizuar në bashkëpunim me GIZ dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë. Gjithashtu po punohet për modernizimin e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, implementimin e sistemit NICS, përmirësimin e sallave operacionale dhe zhvillimin e numrit të unifikuar të emergjencës 112. Këto investime synojnë rritjen e efikasitetit të reagimit dhe forcimin e sigurisë së qytetarëve.

A ka nevojë Shqipëria për më shumë kapacitete ajrore dhe teknologjike për menaxhimin e emergjencave?

Po, zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve ajrore dhe teknologjike mbetet një prioritet i rëndësishëm për sistemin e mbrojtjes civile.

Fenomenet natyrore po bëhen gjithnjë e më komplekse dhe kërkojnë mjete moderne monitorimi, vlerësimi dhe reagimi.

Kapacitetet ajrore janë veçanërisht të rëndësishme për luftën kundër zjarreve në pyje, operacionet e kërkim-shpëtimit dhe mbështetjen e komuniteteve në zona të vështira për t’u aksesuar.

Paralelisht, investimet në sisteme të paralajmërimit të hershëm, teknologji monitorimi, platforma dixhitale dhe sisteme të integruara komunikimi janë thelbësore për përmirësimin e vendimmarrjes dhe reagimit operacional. Shqipëria po punon për forcimin gradual të këtyre kapaciteteve në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Sa e rëndësishme është teknologjia në parashikimin dhe menaxhimin e rreziqeve?

Teknologjia është një element thelbësor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive, nga parandalimi dhe përgatitja deri te reagimi dhe rimëkëmbja. Ajo mundëson monitorimin në kohë reale të rreziqeve, analizën e të dhënave dhe marrjen e vendimeve më të shpejta dhe më efektive. Aktualisht, Shqipëria po zhvillon dhe përdor sisteme të ndryshme teknologjike, si baza kombëtare e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë, sistemi NICS i NATO-s në fazë pilotimi, rrjetet e monitorimit meteorologjik dhe hidrologjik, si dhe teknologjitë për detektimin e hershëm të zjarreve në pyje.

Zhvillimi i mëtejshëm i këtyre sistemeve do të përmirësojë ndjeshëm aftësinë e vendit për të parashikuar, monitoruar dhe menaxhuar rreziqet.

Çfarë roli luajnë pushteti vendor dhe prefekturat në sistemin e mbrojtjes civile?

Pushteti vendor dhe prefekturat janë hallka themelore të sistemit të mbrojtjes civile. Bashkitë përfaqësojnë nivelin e parë të reagimit dhe janë përgjegjëse për organizimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes civile në territorin e tyre, për vlerësimin e riskut, planifikimin, mobilizimin e burimeve lokale dhe mbështetjen e qytetarëve gjatë emergjencave. Prefekti, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në qark, koordinon veprimtarinë e institucioneve në nivel qarku për parandalimin, përgatitjen dhe përballimin e emergjencave civile. Në rastet kur kapacitetet vendore dhe ato të qarkut nuk janë të mjaftueshme, prefekti kërkon mbështetje nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Sistemi funksionon mbi bazën e parimit të subsidiaritetit, ku emergjenca menaxhohet fillimisht në nivel vendor dhe, sipas nevojës, aktivizohet mbështetja në nivele më të larta të sistemit.

A është rritur ndërgjegjësimi i qytetarëve për mënyrën e reagimit në raste emergjencash?

Po, mund të themi se ndërgjegjësimi i qytetarëve për mënyrën e reagimit në raste emergjencash është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Në të kaluarën fokusi ka qenë kryesisht te reagimi pas ndodhjes së fatkeqësive, ndërsa sot sistemi i mbrojtjes civile bazohet në parandalimin, përgatitjen dhe rritjen e reziliencës së komuniteteve. Në këtë kuadër janë zhvilluar fushata të shumta informuese dhe ndërgjegjësuere në të gjithë vendin, aktivitete edukative në shkolla, simulime dhe ushtrime praktike me pjesëmarrjen e komuniteteve.

Një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe iniciativa “Mbrojtja Civile në Turne”, e realizuar në bashkëpunim me UNDP Shqipëri dhe partnerë të tjerë.

Qëllimi ynë është që çdo qytetar të njohë rreziqet e zonës ku jeton, të dijë si të informohet dhe si të reagojë në rast emergjence, sepse një komunitet i përgatitur është më i sigurt dhe më rezilient.

Si po punohet për edukimin e brezit të ri mbi kulturën e sigurisë dhe mbrojtjes civile?

Edukimi i brezit të ri është një nga investimet më të rëndësishme për të ardhmen e sistemit të mbrojtjes civile. AKMC, në bashkëpunim me institucionet e arsimit dhe partnerët ndërkombëtarë, ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh që synojnë përfshirjen e koncepteve bazë të sigurisë dhe mbrojtjes civile në procesin edukativ.

Përmes simulimeve, ushtrimeve praktike, aktiviteteve sensibilizuese dhe programeve të ndërgjegjësimit, të rinjtë njihen me rreziqet natyrore dhe mënyrat e reagimit në situata emergjente.

Një objektiv afatgjatë mbetet integrimi gradual i koncepteve të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile në kurrikulat arsimore, duke krijuar një kulturë të re sigurie që në moshë të hershme.

Çfarë vendi zë vullnetarizmi në sistemin modern të mbrojtjes civile?

Vullnetarizmi është një komponent shumë i rëndësishëm i sistemit modern të mbrojtjes civile dhe një faktor kyç në rritjen e reziliencës së komuniteteve. Përvoja ndërkombëtare tregon se komunitetet me struktura të organizuara vullnetare reagojnë më

shpejt dhe rikuperohen më mirë pas fatkeqësive. Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” parashikon dhe promovon angazhimin e vullnetarëve si pjesë e sistemit kombëtar të mbrojtjes civile. Ata kontribuojnë në aktivitetet parandaluese, sensibilizuese, humanitare dhe në mbështetjen e strukturave operacionale gjatë emergjencave, sipas trajnimit dhe kompetencave të tyre.

AKMC mbështet zhvillimin e strukturave vullnetare dhe nxit pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në ndërtimin e komuniteteve më të sigurta dhe më të përgatitura.

Si e shihni rolin e grave dhe të rinjve në strukturat e emergjencave civile?

Roli i grave dhe të rinjve në sistemin e mbrojtjes civile është thelbësor për ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës dhe efektiv. Gratë sjellin aftësi të rëndësishme në planifikim, koordinim, menaxhim dhe komunikim gjatë emergjencave, ndërsa të rinjtë përfaqësojnë energji, inovacion dhe potencial të madh në edukim, vullnetarizëm dhe sensibilizim. Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë nënvizon rëndësinë e përfshirjes së të gjitha grupeve të shoqërisë në proceset e reduktimit të riskut dhe rritjes së reziliencës.

AKMC mbështet pjesëmarrjen aktive të grave dhe të rinjve në trajnime, simulime, aktivitete ndërgjegjësuere dhe iniciativa të ndryshme që kontribuojnë në forcimin e kulturës së sigurisë në vend.

Cilat janë objektivat kryesore të AKMC-së për vitet e ardhshme?

Objektivi kryesor i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile mbetet konsolidimi i mëtejshëm i sistemit kombëtar të mbrojtjes civile në përputhje me Ligjin nr. 45/2019, Strategjinë Kombëtare për Reduktimin e Riskut nga Fatkeqësitë, Planin Kombëtar të Emergjencave Civile dhe standardet europiane.

Prioritetet tona përfshijnë forcimin e kapaciteteve njerëzore dhe logjistike, modernizimin e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, ngritjen e Qendrës Kombëtare të Trajnimit, zhvillimin e sistemit kombëtar të paralajmërimit të hershëm shumë-rreziqesh dhe implementimin e plotë të numrit të unifikuar të emergjencës 112.

Gjithashtu, do të vazhdojmë të forcojmë bashkëpunimin ndërkombëtar, pjesëmarrjen aktive në Mekanizmin European të Mbrojtjes Civile dhe investimet në edukimin dhe ndërgjegjësimin e komuniteteve.

Ku duhet të fokusohet Shqipëria për të rritur më tej rezistencën ndaj fatkeqësive natyrore?

Shqipëria duhet të vazhdojë të fokusohet në reduktimin e cenueshmërisë së komuniteteve, infrastrukturës dhe sektorëve strategjikë ndaj rreziqeve natyrore. Kjo kërkon forcimin e planifikimit të bazuar në risk, investime në masa parandaluese dhe integrimin e konsideratave të riskut në politikat e zhvillimit. Po aq i rëndësishëm është zhvillimi i sistemeve moderne të paralajmërimit të hershëm, rritja e ndërgjegjësimit publik dhe forcimi i kapaciteteve të institucioneve në të gjitha nivelet. Rezistenca ndaj fatkeqësive nuk ndërtohet vetëm përmes reagimit, por përmes një kulture të vazhdueshme të parandalimit dhe përgatitjes.

Çfarë mesazhi do t’u jepnit institucioneve dhe qytetarëve për rëndësinë e përgatitjes ndaj emergjencave?

Mesazhi im është i thjeshtë: përgatitja shpëton jetë. Fatkeqësitë natyrore nuk mund të parandalohen gjithmonë, por pasojat e tyre mund të reduktohen ndjeshëm nëse institucionet dhe qytetarët janë të përgatitur.

Institucionet duhet të vazhdojnë investimet në trajnim, planifikim, koordinim dhe forcim kapacitetesh. Qytetarët duhet të informohen, të ndjekin udhëzimet e autoriteteve dhe të marrin masa paraprake për sigurinë e tyre dhe të familjeve të tyre.

Në situata emergjente është shumë e rëndësishme të shmangen paniku, dezinformimi dhe spekulimet, duke u mbështetur vetëm te informacioni zyrtar dhe udhëzimet e strukturave kompetente.

Si e imagjinoni sistemin shqiptar të mbrojtjes civile pas 10 vitesh?

E shoh si një sistem plotësisht të integruar me standardet më të mira europiane, me institucione të forta, personel të trajnuar sipas praktikave më të avancuara dhe kapacitete moderne teknologjike.

Synimi ynë është që Shqipëria të disponojë sisteme efektive të paralajmërimit të hershëm, qendra moderne operacionale, struktura të afta reagimi dhe komunitete të mirë përgatitura për përballimin e çdo lloj fatkeqësie.

Në këtë mënyrë do të kemi një sistem më rezilient, më efikas dhe më të aftë për të garantuar sigurinë e qytetarëve.

Cili është parimi që ju ka udhëhequr gjatë gjithë karrierës suaj në shërbim të sigurisë publike?

Parimet që më kanë udhëhequr gjatë gjithë karrierës sime kanë qenë ndershmeria, integriteti, përkushtimi dhe profesionalizmi. Kam besuar gjithmonë se shërbimi publik kërkon përgjegjësi, transparencë dhe vendosjen e interesit të qytetarëve mbi çdo interes tjetër.

Këto vlera më kanë shoqëruar si në Policinë e Shtetit, ashtu edhe në drejtimin e sistemit të mbrojtjes civile.

Në fund, çfarë do të dëshironit të mbahej mend nga puna dhe kontributi juaj në shërbim të vendit?

Do të doja që të mbahej mend përkushtimi im ndaj detyrës, integriteti në vendimmarrje dhe përpjekja e vazhdueshme për t’i shërbyer vendit me përgjegjësi dhe profesionalizëm.

Besoj se institucionet forcohen jo vetëm nga strukturat dhe rregullat, por edhe nga vlerat që lënë pas njerëzit që i drejtojnë ato. Nëse kam kontribuar qoftë edhe modestisht në forcimin e sigurisë publike, zhvillimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe mbrojtjen e qytetarëve, atëherë kjo do të ishte trashëgimia më e çmuar e punës sime.



Arsimi ushtarak drejt së ardhmes: Konferencë shkencore në Akademinë e Forcave të Armatosura për sfidat dhe inovacionin në arsimin e lartë

Akademia e Forcave të Armatosura, forum i ideve për arsimin e së ardhmes

Akademia e Forcave të Armatosura organizoi konferencën shkencore me temë **“Transformimi i Arsimit të Lartë: Sfida, Inovacion dhe Perspektiva”**, një aktivitet i rëndësishëm akademik që mbledhi drejtues të institucioneve të mbrojtjes, autoritete akademike, pedagogë, studiues dhe specialistë të fushës së arsimit, me qëllim diskutimin e zhvillimeve, sfidave dhe mundësive që lidhen me modernizimin e arsimit të lartë ushtarak në Shqipëri.

Konferenca u zhvillua në një kohë kur transformimi i arsimit të lartë dhe përshtatja e tij me kërkesat e një mjedisi sigurie gjithnjë e më kompleks dhe dinamik përbën një prioritet të rëndësishëm për Forcat e Armatosura dhe sistemin e mbrojtjes në tërësi.

Në hapje të punimeve, pjesëmarrësit u përshëndetën nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant **Arben Kingji**, i cili vlerësoi rëndësinë e kësaj konference si një platformë e vlefshme për shkëmbimin e ideve dhe përvojave mbi të ardhmen e arsimit të lartë ushtarak.

Në mesazhin e tij, gjeneralletënant Kingji theksoi se transformimi i arsimit të lartë ushtarak përbën një investim strategjik për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe për rritjen e cilësisë së arsimit dhe stërvitjes në Forcat e Armatosura.

Ai nënvizoi se modernizimi i programeve akademike dhe harmonizimi i tyre me standardet e NATO-s, janë elementë thelbësorë për përgatitjen e profesionistëve të aftë për të përballuar sfidat e sigurisë së sotme dhe të së ardhmes.

“Transformimi i arsimit të lartë ushtarak përbën një investim strategjik për zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe për rritjen e cilësisë së arsimit dhe stërvitjes, duke iu përgjigjur nevojave operationale të kohës dhe duke u harmonizuar me standardet e NATO-s. Kjo qasje kontribuon në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të përballuar sfidat e sigurisë në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe dinamik”, - theksoi gjeneralletënant Kingji



Akademia, qendër e zhvillimit të mendimit ushtarak

Në vijim të konferencës, Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneralmajor **Ferdinand Dimo**, përshëndeti pjesëmarrësit dhe vlerësoi rëndësinë e organizimit të aktiviteteve të tilla shkencore në funksion të zhvillimit të mendimit strategjik dhe akademik.

Ai u ndal te roli i Akademisë si institucioni më i lartë

arsimor ushtarak në vend, duke theksuar angazhimin e saj për të ofruar programe bashkëkohore studimi dhe për të nxitur kërkimin shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjeneralmajor Dimo vuri në dukje se sfidat e reja të sigurisë kërkojnë jo vetëm pajisje dhe teknologji moderne, por mbi të gjitha personel të përgatitur, me njohuri të avancuara akademike dhe profesionale.



Sipas tij, investimi në dije dhe në zhvillimin profesional të brezave të rinj të ushtarakëve mbetet një nga garancitë më të rëndësishme për suksesin e Forcave të Armatosura në përmbushjen e misionit të tyre.

Në emër të lidërshit politik të Ministrisë së Mbrojtjes, konferencën e përshëndetën zëvendësministrat **Pranvera Skana** dhe **Enkelejd Joti**.

Në fjalën e tij, zëvendësministri Enkelejd Joti theksoi rëndësinë që Ministria e Mbrojtjes i kushton zhvillimit të arsimit të lartë ushtarak si një nga shtyllat kryesore të modernizimit të sektorit të mbrojtjes.

Ai vlerësoi rolin e Akademisë së Forcave të Armatosura në përgatitjen e kuadrove të rinj dhe në ndërtimin e kapaciteteve profesionale të nevojshme për përballimin e sfidave aktuale të sigurisë.

Zëvendësministri Joti theksoi se investimi në edukim, kërkim shkencor dhe inovacion është investim në të ardhmen e Forcave të Armatosura dhe të sigurisë kombëtare.

Një forum për shkëmbimin e ideve dhe përvojave

Punimet e konferencës u fokusuan në tema që lidhen me transformimin e arsimit të lartë, përdorimin e teknologjive të reja në procesin mësimor, zhvillimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e metodologjive të mësimdhënies dhe përshtatjen e programeve akademike me kërkesat e kohës.



Në hapje të punimeve, pjesëmarrësit u përshëndetën nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili vlerësoi rëndësinë e kësaj konference si një platformë e vlefshme për shkëmbimin e ideve dhe përvojave mbi të ardhmen e arsimit të lartë ushtarak.

Pedagogë, studiues dhe ekspertë prezantuan kumtesa dhe studime mbi sfidat që shoqërojnë procesin e transformimit të arsimit, si dhe mbi mundësitë që ofrojnë inovacioni dhe teknologjitë moderne për rritjen e cilësisë së edukimit.

Diskutimet evidentuan nevojën për një qasje gjithnjë e më të integruar mes arsimit, kërkimit shkencor dhe praktikës profesionale, me synim përgatitjen e liderëve dhe specialistëve të aftë për të operuar në një mjedis sigurie të karakterizuar nga ndryshime të shpejta dhe sfida komplekse.

Investim për të ardhmen

Konferenca shkencore **“Transformimi i Arsimit të Lartë: Sfida, Inovacion dhe Perspektiva”**, konfirmoi edhe një herë rolin e Akademisë së Forcave të Armatosura si një qendër e rëndësishme e dijes, kërkimit shkencor dhe zhvillimit profesional. Në përfundim të aktivitetit, gjenerallejtënant Arben Kingji shprehu mirënjohjen për organizatorët, pedagogët, studiuesit dhe të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e tyre në suksesin e konferencës, duke theksuar se përmes nismave të tilla forcohen bazat për një sistem arsimor ushtarak modern, cilësor dhe të orientuar drejt së ardhmes.

Konferenca dëshmoi se investimi në arsim, dije dhe inovacion mbetet një nga garancitë më të sigurta për zhvillimin e Forcave të Armatosura dhe për përgatitjen e brezave të rinj që do të mbajnë përgjegjësitë e sigurisë dhe mbrojtjes së vendit në vitet që vijnë.

KUJTESA E NJË KOMBI QË NUK HARRON

Dita Botërore e Refugjatëve: Historia jonë, dhimbja e tyre

Më 20 qershor, bota ndalet për të reflektuar mbi fatin e miliona njerëzve që janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për shkak të luftës, dhunës, persekutimit dhe krizave humanitare. E themeluar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, Dita Botërore e Refugjatëve nuk është thjesht një datë në kalendarin ndërkombëtar. Ajo është një thirrje ndërgjegjeje për njerëzimin, një moment për të kujtuar se pas çdo statistike fshihet një histori njerëzore, një familje e ndarë, një fëmijë i trembur, një nënë që mban mbi supe barrën e mbijetesës dhe një baba që kërkon siguri për të ardhmen e fëmijëve të tij.

Për popullin shqiptar, kjo ditë ka një domethënie të veçantë. Ajo nuk është vetëm një histori që e lexojmë në raportet ndërkombëtare apo e shohim në ekranet televizive. Është një kujtim i gjallë, një plagë kolektive që ende jeton në kujtesën e mijëra familjeve shqiptare. Ne e dimë çfarë do të thotë të largohesh me forcë nga shtëpia. Ne e dimë çfarë do të thotë të humbasësh sigurinë, tokën, lagjen, shkollën, kujtimet dhe jetën e zakonshme brenda pak orësh. Historia jonë kombëtare është e mbushur me kapituj dhimbjeje, shpërnguljeje dhe mërgimi të detyruar.

Në fundin e shekullit të kaluar, gjatë viteve të errëta të konfliktit në Kosovë, shqiptarët përjetuan një nga trageditë më të mëdha humanitare në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Mbi një milion shqiptarë të Kosovës u detyruan të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Familje të tëra u nisën drejt kufijve me vetëm pak rroba në duar dhe me shpresën se do të mund të mbijetonin. Në ato ditë dramatike, bota pa kolona të pafundme njerëzish që largoheshin nga trojet e tyre. Pa gra që mbanin fëmijët në krahë, të moshuar që ecnin me vështirësi dhe të rinj që nuk dinin nëse do të mund të ktheheshin ndonjëherë në shtëpitë e tyre.

Por ajo që bota pa gjithashtu ishte zemra e madhe e shqiptarëve. Shqipëria, një vend që vetë po përballej me vështirësi ekonomike dhe sociale, hapi dyert për qindra mijëra refugjatë.

Nga Kosova e vitit 1999 te refugjatët e botës sot

Familjet shqiptare ndanë bukën, shtëpitë, oborret dhe shpresën me vëllezërit e motrat e tyre nga Kosova. Në qytete dhe fshatra, njerëzit pritën të panjohur si pjesë të familjes. Nuk kishte nevojë për protokolle apo ceremoni. Ishte një reagim njerëzor, i natyrshëm, i lindur nga ndjenja e përbashkët e identitetit dhe dhimbjes.

Kjo histori nuk duhet harruar kurrë.

Ajo duhet të mbetet një mësim për brezat e rinj dhe një kujtesë për të gjithë ata që sot shohin refugjatët vetëm si numra. Sepse refugjati nuk është një statistikë. Ai është një njeri. Ai ka një emër, një histori, një profesion, një familje, ëndrra dhe kujtime. Askush nuk zgjedh të bëhet refugjat. Askush nuk largohet me dëshirë nga shtëpia e vet, nga vendi ku ka lindur, nga toka ku prehen të parët e tij. Refugjat bëhesh kur jeta të detyron të zgjedhësh mes qëndrimit dhe mbijetesës.

Dita Botërore e Refugjatëve është një ditë e reflektimit moral. Ajo na kujton se njerëzimi matet jo nga mënyra se si trajton të fortët, por nga mënyra se si trajton më të pambrojturit. Shoqëritë demokratike dhe shtetet moderne nuk vlerësohen vetëm nga zhvillimi ekonomik apo fuqia politike, por edhe nga aftësia për të mbrojtur dinjitetin njerëzor.

Askush nuk zgjedh të bëhet refugjat

Sot, miliona refugjatë nëmbarë botën vazhdojnë të kërkojnë strehë dhe siguri. Konfliktet e armatosura,



persekutimi politik, dhuna etnike dhe katastrofat humanitare vazhdojnë të detyrojnë njerëzit të largohen nga vendet e tyre. Në një botë që shpesh duket e ndarë nga interesat politike, çështja e refugjatëve mbetet një provë e madhe për ndërgjegjen globale. Prandaj, tri shtyllat kryesore të kësaj dite: mirënjohja, mikpritja dhe përgjegjësia globale, nuk duhet të mbeten vetëm slogane.

Mirënjohja nënkupton respekt për forcën dhe guximin e atyre që kanë humbur gjithçka, por nuk kanë humbur shpresën. Çdo refugjat mbart me vete një histori rezistence. Çdo familje që arrin të rindërtojë jetën në një vend të ri është një dëshmi e jashtëzakonshme e qëndrueshmërisë njerëzore.

Mikpritja dhe integrimi janë sfida të vazhdueshme për çdo shoqëri. Nuk mjafton vetëm hapja e kufijve. Duhet të hapen edhe mundësitë. Refugjatët kanë nevojë për strehim, arsim, punë dhe përfshirje sociale. Ata kanë nevojë të ndihen të sigurt dhe të respektuar. Integrimi nuk është një akt bamirësie; është një investim në dinjitetin dhe potencialin njerëzor.

Përgjegjësia globale kërkon bashkëpunim ndërkombëtar dhe solidaritet. Asnjë shtet nuk mund ta përballojë i vetëm një krizë të madhe refugjatësh. Por asnjë shtet nuk duhet të qëndrojë indiferent përballë vuajtjeve njerëzore. Solidariteti nuk është zgjedhje politike; ai është detyrim moral.

Shqipëria ka arsye të jetë krenare për rolin që ka luajtur historikisht në mbrojtjen e njerëzve në nevojë. Tradita shqiptare e mikpritjes nuk është thjesht një pjesë e folklorit tonë. Ajo është provuar në momentet më të vështira të historisë. Është provuar kur shqiptarët hapën dyert për refugjatët e luftës, kur ndanë pak nga ajo që kishin dhe kur treguan se humanizmi nuk matet me pasuri, por me zemër. Megjithatë, krenaria për të kaluarën duhet të shoqërohet

me përgjegjësi për të ardhmen. Brezat që nuk e kanë përjetuar luftën duhet të mësojnë se paqja nuk është e përhershme dhe se liria nuk është e garantuar. Historia e refugjatëve shqiptarë duhet të mbetet pjesë e kujtesës sonë kolektive, jo për të ushqyer dhimbjen, por për të kultivuar empatinë.

Sepse vetëm ai që e njeh vuajtjen e kupton plotësisht dhimbjen e tjetrit.

Në këtë 20 qershor, ndërsa flamujt e organizatave ndërkombëtare ngrihen dhe mbahen fjalime në shumë vende të botës, shqiptarët kanë një arsye më shumë për të reflektuar. Ne nuk flasim për refugjatët si vëzhgues të largët. Ne flasim si njerëz që e kemi jetuar atë histori. Ne e dimë si tingëllon trokitja e pasigurisë në derën e shtëpisë. Ne e dimë çfarë do të thotë të largohesh me lot në sy dhe me shpresën se një ditë do të kthehesh.

Asnjë popull nuk është i imunizuar nga tragjedia e shpërnguljes së detyruar dhe asnjë njeri nuk duhet të mbetet vetëm përballë saj.

Le të kujtojmë të kaluarën tonë. Le të nderojmë ata që kanë vuajtur. Le të mbështesim ata që ende kërkojnë një strehë të sigurt. Dhe mbi të gjitha, le të mos harrojmë kurrë se humanizmi fillon aty ku mbarojnë paragjykimet.

Sepse refugjatët nuk kanë nevojë vetëm për strehim. Ata kanë nevojë për dinjitet, respekt dhe shpresë.

Dhe pikërisht këto janë vlerat që një komb që ka njohur dhimbjen e mërgimit duhet t'i mbrojë gjithmonë. Shqipëria e di këtë më mirë se kushdo tjetër. Në fund të fundit, historia e refugjatëve nuk është thjesht historia e tyre. Në shumë mënyra, ajo është edhe historia jonë.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve**Nga Ajnshtajni tek ditët tona, kriza e mendimit në shoqërinë moderne**

Në historinë e njerëzimit ka njerëz që lënë pas shpikje, ka të tjerë që lënë pas pasuri, ka edhe nga ata që ndërtojnë institucione, shtete apo perandori. Por shumë pak janë ata që lënë pas një mënyrë të re të menduari. Albert Ajnshtajni ishte një prej tyre. Emri i tij është bërë sinonim i gjenialitetit, por ndoshta madhështia e tij e vërtetë nuk qëndron vetëm te teoritë që ndryshuan fizikën moderne. Ajo që e bën të pavdekshëm është fakti se ai mbeti njeri i thjeshtë në një kohë kur e gjithë bota e adhuronte.

Sot, kur lexon historitë, kujtimet dhe anekdotat që kanë mbetur nga jeta e tij, kupton se përballë nuk ke vetëm një shkencëtar të madh, por një filozof të jetës. Një njeri që e kuptoi se inteligjenca nuk ka vlerë nëse nuk shoqërohet me përlësi, se fama nuk ka kuptim nëse nuk i shërben njerëzimit dhe se dija është e kotë nëse nuk e bën njeriun më të mirë.

Shoqëria e sotme duket sikur ecën në drejtim të kundërt me këto parime. Kurrë më parë njerëzimi nuk ka pasur kaq shumë informacion, por paradoksalisht kaq pak kohë për të menduar. Kurrë më parë nuk kemi komunikuar kaq shumë, por kaq pak kemi dëgjuar njëri-tjetrin. Kurrë më parë nuk kemi qenë kaq të lidhur përmes teknologjisë, por kaq të largët në marrëdhëniet njerëzore.

Në këtë realitet të mbushur me zhurmë, figura e Ajnshtajnit ngjan si një kujtesë e largët e një kohe kur vlera e njeriut matej me atë që krijonte dhe jo me atë që shfaqte.

Thuhet se ai foli vonë, se ishte fëmijë i heshtur dhe se shqetësoi prindërit e tij për këtë arsye. E vërtetë apo jo, historia mbart një simbolikë të fortë. Në një botë ku të gjithë duan të flasin, ndoshta na duhet të mësojmë përsëri vlerën e heshtjes. Sepse idetë e mëdha nuk lindin në zhurmë. Ato lindin në qetësi, në reflektim dhe në dialogun e brendshëm të njeriut me vetveten.

Ajnshtajni e donte ecjen. Nuk kishte makinë. Nuk e ndiente të nevojshme. Ecja për të nuk ishte vetëm lëvizje fizike. Ishte kohë për të menduar. Sot, edhe kur kemi vetëm pak minuta të lira, nxitojmë të mbushim mendjen me ekran, me lajme, me rrjete sociale dhe me informacione të pafundme. Kemi harruar të ecim me mendimet tona. Kemi harruar të ndalojmë dhe të pyesim veten se ku po shkojmë si individë dhe si shoqëri.

Një nga fotografitë më të famshme të historisë është ajo ku Ajnshtajni nxjerr gjuhën para aparatit fotografik. Një gjest spontan që sfidoi seriozitetin artificial të famës. Ndoshta edhe aty fshihet një mësim. Njeriu që kishte ndryshuar mënyrën se si kuptohej universi nuk kishte nevojë të luante rolin e gjeniut të paarritshëm. Ai dinte të qeshte me veten.

Në kohën e zhurmës, na duhet mençuria e thjeshtësisë

Sot jetojmë në kohën e kultit të imazhit. Të gjithë përpiqen të duken të përsosur. Të gjithë duan të projektojnë sukses, lumturi dhe siguri absolute.


Por historia na tregon se njerëzit më të mëdhenj nuk kanë qenë kurrë ata që përpiqeshin të duken të pagabueshëm. Ata kanë qenë me pranimin e kufijve të tyre njerëzorë.

Ndoshta pikërisht për këtë arsye Ajnshtajni vazhdon të frymëzojë. Jo sepse dinte gjithçka, por sepse ishte gjithmonë i gatshëm të mësonte. Ai ndihmonte një nxënëse të vogël me detyrat e matematikës, bisedonte me fëmijët, dëgjonte njerëzit e zakonshëm dhe ruante kuriozitetin e një fëmije edhe kur ishte bërë shkencëtar i më i njohur në planet.


Kjo është një nga sëmundjet e kohës sonë: humbja e kuriozitetit.

Shpesh mendojmë se kemi përgjigje për gjithçka. Kemi harruar të bëjmë pyetje. Kemi harruar të dyshojmë, të kërkojmë dhe të mësojmë. Ndërkohë, përparimi i njerëzimit ka lindur gjithmonë nga pyetjet dhe jo nga bindjet absolute.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i jetës së Ajnshtajnit ishte raporti i tij me pushtetin. Kur iu ofrua posti i Presidentit të



Mësimet e Ajnshtajnit për një Botë që Ka Harruar të Mendojë



Izraelit, ai refuzoi. Jo sepse nuk e vlerësonte nderin, por sepse mendonte se nuk ishte njeriu i duhur për atë detyrë. Sa rrallë dëgohet sot një përgjigje e tillë! Në një epokë ku shumë njerëz kërkojnë poste edhe kur nuk janë të përgatitur për to, një njeri me famë botërore pati guximin të pranonte kufijtë e tij.

Ky është një leksion që vlen për çdo shoqëri. Institucionet nuk forcohen nga ambicia personale, por nga përgjegjësia. Drejtimi nuk është privilegj. Është barrë. Dhe vetëm ata që e kuptojnë këtë mund të jenë drejtues të mirë.

Po aq domethënëse është historia e çekut që e përdori si shënues libri dhe më pas e humbi. Në një kohë kur paraja është bërë shpesh kriteri kryesor i suksesit, ky episod na kujton se ka njerëz për të cilët vlera e mendimit ka qenë më e madhe se vlera e parasë.

Nuk është rastësi që edhe fitimet nga autografet e tij i përdorte për bamirësi. Ai e kuptonte se privilegji sjell përgjegjësi. Sa më shumë të marrësh nga shoqëria, aq më shumë duhet t'i kthesh asaj.

Sot, kur pabarazitë ekonomike po thellohen dhe kur individualizmi po fiton terren, ky mesazh tingëllon më aktual se kurrë. Një shoqëri nuk matet nga pasuria e më të pasurve, por nga mënyra se si kujdeset për më të dobët.

Edhe dashuria e Ajnshtajnit për muzikën përmban një mesazh të rëndësishëm. Ai e konsideronte muzikën një mënyrë tjetër për të kuptuar botën. Në kohën tonë, kur arsimi po fokusohet gjithnjë e më shumë vetëm te rezultatet praktike dhe fitimi ekonomik, harrojmë se arti, letërsia, muzika dhe kultura janë po aq të rëndësishme sa shkenca.

Ato e bëjnë njeriun më të plotë.

Ndoshta kjo është arsyeja pse figura e Ajnshtajnit vazhdon të jetojë përtej laboratorëve dhe universiteteve.

Ai nuk ishte vetëm fizikan. Ishte simbol i një humanizmi të thellë. Një njeri që besonte se dija duhet t'i shërbejë paqes, se shkenca duhet t'i shërbejë njerëzimit dhe se njeriu duhet të mbetet njeri pavarësisht arritjeve të tij.

Në fund të fundit, bota jonë nuk ka nevojë vetëm për më shumë teknologji. Nuk ka nevojë vetëm për më shumë zhvillim ekonomik. Ajo ka nevojë për më shumë mençuri.

Ka nevojë për njerëz që mendojnë para se të flasin. Për drejtues që shërbejnë para se të urdhërojnë. Për të rinj që kërkojnë dijen para famës. Për qytetarë që vendosin interesin publik mbi atë personal.

Albert Ajnshtajni na kujton se madhështia e vërtetë nuk qëndron te titujt, çmimet apo fama. Ajo qëndron te aftësia për të mbetur i thjeshtë kur mund të bëhesh arrogant, i ndershëm kur mund të përfitosh dhe njerëzor kur bota të vendos në pedestal.

Prandaj, më shumë se një shekull pas zbulimeve të tij, mesazhi i tij mbetet aktual. Në kohën e zhurmës, kemi nevojë për njerëz që mendojnë. Në kohën e egoizmit, kemi nevojë për njerëz që shërbejnë. Në kohën e dukjes, kemi nevojë për njerëz që janë.

Dhe ndoshta ky është relativiteti më i rëndësishëm që duhet të kuptojë shoqëria moderne: se vlera e njeriut nuk matet me atë që zotëron, por me atë që lë pas.

NGA JOLANDA KLOSI-XHUVANI TE GRATË USHTARAKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, NJË TRASHËGIMI GUXIMI, SAKRIFICE DHE SHËRBIMI NDAJ ATDHEUT

Jolanda Klosi-Xhuvani, pionierja e grave shqiptare në uniformë

Nga Jolanda Klosi-Xhuvani te gratë ushtarake të Forcave të Armatosura sot

Ka gra që historia i kujton për postet që mbajtën dhe ka gra që mbeten në kujtesën e një kombi për shembullin që lanë. Një prej tyre është pa dyshim Jolanda Klosi-Xhuvani, vajza e një prej figurave më të ndritura të arsimit shqiptar, por njëkohësisht edhe një nga gratë që zgjodhi të mos mbetej në hijen e emrit të familjes, duke shkruar me guxim faqen e saj në historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Të jesh grua në Shqipërinë e viteve ’40 nuk ishte e lehtë. Të jesh grua dhe të marrësh armën në dorë, të luftosh në male, të përballesh me rrezikun, burgun dhe vdekjen, kërkonte një forcë të jashtëzakonshme karakteri. Jolanda Klosi-Xhuvani ishte një prej atyre grave që sfiduan kohën e tyre dhe dëshmuar se dashuria për atdheun nuk njih dallim mes burrit dhe gruas.

E lindur në Elbasan, më 12 gusht 1922, në familjen e Aleksandër Xhuvanit, ajo u edukua me dashurinë për dijen, gjuhën shqipe dhe vlerat kombëtare. Por brezi i saj nuk pati luksin të jetonte vetëm me libra. Shqipëria ishte e pushtuar dhe rinia shqiptare po përballej me një nga sfidat më të mëdha të historisë së saj.

Në vitet e errëta të pushtimit fashist, Jolanda iu bashkua Lëvizjes Antifashiste. Arrestimet, përndjekjet dhe rreziku i përhershëm nuk e ndalën. Dy herë ra në duart e shërbëtorëve të Gestapos, por arriti të shpëtonte dhe të vazhdonte rrugën e rezistencës.

Kur u krijua Brigada e 17-të Sulmuese në Gjinar të Elbasanit, ajo u rreshtua mes partizanëve të saj. Fillimisht luftëtare e thjeshtë, më pas falë aftësive organizative, vendosmërisë dhe autoritetit që fitoi në terren, u emërua zëvendëskomisare e Batalionit të Dytë.

Në një kohë kur komandimi ushtarak konsiderohej thujase ekskluzivisht fushë e burrave, Jolanda Klosi-Xhuvani dëshmoi se një grua mund të drejtonte, të organizonte dhe të fitonte respektin e shokëve të armëve po aq sa çdo komandant tjetër.

Ajo mori pjesë në disa prej luftimeve më të rëndësishme të luftës, mes tyre edhe në betejën e Mushqetasë në nëntor 1944, një nga përballjet vendimtare në prag të çlirimit të vendit. Por historia e saj nuk përfundon me mbarimin e luftës.

Lufta tjetër: Ndërtimi i jetës

Shumë prej atyre që luftuan për lirinë e vendit u përballën më pas me sfidën e ndërtimit të paqes. Edhe për Jolandën nisi një tjetër mision.

Pas çlirimit ajo punoi në detyra të ndryshme drejtuese dhe arsimore, duke shërbyer në institucione të rëndësishme të vendit. Për dekada me radhë dha kontribut në formimin e brezave të rinj në Politeknikumin “7 Nëntori”, në gjimnazin “Qemal Stafa”, në Institutin Pedagogjik, Institutin Bujqësor të Kamzës dhe Institutin e Lartë të Arteve.

U martua me Bilbil Klosin dhe krijoi një familje të madhe me pesë fëmijë, nipër e mbesa. Ata që e njohën kujtojnë jo



Figura e Jolanda Klosi-Xhuvanit nuk është vetëm një kujtim i historisë. Ajo është një simbol. Simbol i guximit për të marrë përgjegjësi. Simbol i përkushtimit ndaj detyrës. Simbol i besimit se shërbimi ndaj vendit nuk ka gjini. Kur shohim sot gratë ushtarake shqiptare në radhët e Forcave të Armatosura, është e pamundur të mos kujtojmë gratë që dekada më parë hapën këtë rrugë me sakrificë dhe idealizëm.

vetëm partizanen dhe drejtuesen, por mbi të gjitha gruan fisnike, nënën e përkushtuar, edukatoren dhe qytetaren e respektuar.

Jeta i solli edhe dhimbje të mëdha, por asnjëherë nuk e humbi dinjitetin dhe forcën që e karakterizonte.

Nga brigadat partizane te Forcat e Armatosura moderne

Sot Shqipëria është anëtare e NATO-s dhe Forcat e Armatosura shqiptare janë krejt ndryshe nga ato të kohës së luftës. Megjithatë, ekziston një fije e padukshme që lidh brezat.

Ajo fije quhet shërbim ndaj atdheut.

Në repartet, komandat, shtabet dhe misionet ndërkombëtare të Forcave të Armatosura shqiptare shërbejnë qindra gra ushtarake. Ato janë oficerë, nënoficerë, pilote, specialiste të logistikës, mjeke ushtarake, eksperte të sigurisë kibernetike, pjesëtare të forcave tokësore, detare dhe ajrore.

Nëse dikur grave u duhej të fitonin të drejtën për të qenë pjesë e strukturave ushtarake, sot ato janë pjesë e natyrshme e tyre.

Megjithatë, rruga nuk ka qenë e lehtë.

Ashtu si Jolanda Klosi-Xhuvani dhe shumë bashkëluftëtare të saj, edhe gratë ushtarake të ditëve

tona kanë sfiduar paragjykime, stereotipa dhe vështirësi profesionale për të dëshmuar se aftësia, përkushtimi dhe profesionalizmi nuk varen nga gjinia.

Në misionet paqeruajtëse jashtë vendit, në operacionet e kërkim-shpëtimit, në stërvitjet ndërkombëtare apo në detyrat e përditshme brenda vendit, ato mbajnë me krenari uniformën shqiptare dhe përfaqësojnë denjësisht Forcat e Armatosura.

Një trashëgimi që vazhdon

Figura e Jolanda Klosi-Xhuvanit nuk është vetëm një kujtim i historisë. Ajo është një simbol. Simbol i guximit për të marrë përgjegjësi. Simbol i përkushtimit ndaj detyrës. Simbol i besimit se shërbimi ndaj vendit nuk ka gjini.

Kur shohim sot gratë ushtarake shqiptare në radhët e Forcave të Armatosura, është e pamundur të mos kujtojmë gratë që dekada më parë hapën këtë rrugë me sakrificë dhe idealizëm.

Nga malet e luftës te bazat moderne ushtarake, nga batalionet partizane te misionet e NATO-s, historia e gruas shqiptare në uniformë është historia e një përkushtimi që nuk është ndërprerë kurrë.

Dhe në atë histori, emri i Jolanda Klosi-Xhuvanit zë një vend të nderuar.

Sepse të jesh grua nuk do të thotë vetëm të përballesh me sfidat e kohës.

Të jesh grua do të thotë të kesh forcën për t'i kapërcyer ato.

Ashtu siç bëri Jolanda.



SHERIF ÇIÇIKU, TRAJNERI QË NDËRTOI BREZA KAMPIONËSH DHE SHKROI HISTORINË E FUTBOLLIT SKËNDERBEGAS

Në historinë e gjatë të Shkollës Ushtarake “Skënderbej”, ku për dekada u formuan ushtarakë, intelektualë, sportistë dhe personalitete të shquara të vendit, ka emra që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme. Njëri prej tyre është pa dyshim Sherif Çiçiku, njeriu që për më shumë se tri dekada lidhi jetën e tij me futbollin skënderbegas dhe që u bë zbuluesi, edukatori dhe trajneri i qindra talenteve që më vonë shkëlqyen në futbollin shqiptar.

Për shumë breza skënderbegasish, emri i Sherif Çiçikut nuk lidhet vetëm me futbollin. Ai lidhet me përkushtimin, disiplinën, edukimin sportiv dhe njerëzor. Ai ishte trajneri që nuk kërkonte vetëm rezultate në fushë, por formimin e karakterit, frymës së ekipit dhe ndjenjës së përgjegjësisë tek të rinjtë që stërviste.

Edhe sot, vite pas daljes në pension, dera e shtëpisë së tij vazhdon të trokasë nga ish-nxënësit e tij. Disa prej tyre kanë qenë yje të futbollit shqiptar, të tjerë kanë ndërtuar karriera në fusha të ndryshme të jetës, por të gjithë ruajnë të njëjtin respekt për njeriun që u mësoi hapat e parë drejt suksesit.

Një fëmijë i Tiranës që u dashurua me futbollin

Sherif Çiçiku lindi më 4 dhjetor 1939, në Tiranë. Si shumë fëmijë të kohës së tij, orët më të bukura i kalonte duke luajtur futboll në rrugicat dhe sheshet e lagjes. Topi ishte lodra më e dashur dhe loja më e preferuar. Atëherë nuk mund ta imagjinonte se futboli do të bëhej pasioni që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Shkollën 7-vjeçare e kreu tek “Shkolla e Kuqe”, në Tiranë. Krahas sportit, kishte një pasion tjetër të madh: mekanikën. I pëlqente të merrej me motorë dhe automjete, aq sa ëndrra e tij e hershme ishte të bëhej shofer profesionist.

Kur erdhi koha e shërbimit ushtarak, ai ndoqi kursin për shofer dhe më pas shërbeu në Korçë. Aftësitë e tij në drejtimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve ranë shpejt në sy. Një ngjarje që do t'i ndryshonte jetën ndodhi kur komandanti i Shkollës “Skënderbej”, kolonel Luto Haxhi, kërkoj një shofer të aftë. Sherifi u përzgjedh dhe u transferua në Tiranë. Ishte një moment vendimtar.

Takimi me “Skënderbeun”, që i ndryshoi jetën

Në fillim ai mendoi se do të ishte thjesht shofer i komandantit. Por fati kishte rezervuar diçka tjetër. Kur komandanti i besoi riparimin e një automjeti pothuajse të shkatërruar, Sherifi tregoi aftësitë e tij të jashtëzakonshme si mekanik. Automjeti u rikthye në gjendje perfekte dhe kjo bëri përshtypje tek drejtuesit e shkollës. Ndërkohë, ai nisi të aktivizohej edhe me ekipin e futbollit të shkollës.

Talenti, pasioni dhe njohuritë e tij për lojën e bënë shpejt pjesë të stafit teknik.

Në vitin 1961, së bashku me trajnerin e njohur Bejkush Birçe, ai mori drejtimin e ekipit të futbollit të shkollës “Skënderbej”.

Kur Birçe angazhohej me ekipe të tjera, barra kryesore e punës binte mbi Sherif Çiçikun. Dhe rezultatet nuk vonuan.

Epoka e artë e futbollit skënderbegas

Në historinë e sportit shkollor shqiptar, ekipi i futbollit i

Shkollës “Skënderbej” mbetet një fenomen i veçantë.

Nën drejtimin e Sherif Çiçikut, ekipi dominoi kampionatet kombëtare të shkollave të mesme.

Në 10 kampionate të zhvilluara, skënderbegasit fituan 8 tituj kampionë. Kjo ishte një arritje e jashtëzakonshme, sidomos po të kemi parasysh nivelin e kundërshtarëve.

Në finale, kundërshtari kryesor ishte Politeknikumi “17 Nëntori”, një shkollë që kishte në përbërje lojtarë të ekipeve elitare të kryeqytetit dhe futbollistë të kombëtares.

Megjithatë, skënderbegasit triumfonin vazhdimisht.

Kjo periudhë konsiderohet ende sot si epoka e artë e futbollit të shkollës.

Letra që mbërriti në zyrën e Mehmet Shehut

Një nga episodet më interesante të karrierës së tij lidhet me përpjekjen për ta ngjitur ekipin në kategorinë e parë. Pavarësisht rezultateve dhe titujve të fituar, ekipi nuk lejohej të ngjitej në elitën e futbollit shqiptar.

Arsyeja ishte burokratike: Ministria e Mbrojtjes kishte tashmë ekipin “Partizani” dhe rregulloret nuk lejonin një ekip të dytë ushtarak në të njëjtën kategori. Sherif Çiçiku vendosi të mos heshhte. Ai i shkroi drejtpërdrejt Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes të kohës, Mehmet Shehu. Në letër argumentonte padrejtësinë që po i bëhej ekipit.

Veprimi i tij shkaktoi reagime të menjëhershme. U zhvilluan takime, diskutime dhe më në fund u vendos një provë: një ndeshje mes ekipit të Shkollës “Skënderbej” dhe ekipit të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve, ku luanin shumë futbollistë të “Partizanit”.

Ndeshja që hyri në histori

Atmosfera e asaj ndeshjeje kujtohet ende sot. Stadiumi ishte mbushur me tifozë. Skënderbegasit kishin ardhur me daulle improvizuese, kapakë tenxheresh dhe një entuziazëm të jashtëzakonshëm. Përballë tyre ishte një ekip shumë më me eksperiencë. Por në fushë ndodhi surpriza. Skënderbegasit fituan me rezultatin 3–1. Ishte një fitore që tregoi qartë nivelin e ekipit.

Pas ndeshjes, zëvendësministri Maliq Sadushi e uroi Sherif Çiçikun me fjalët:

“Paske të drejtë!” Megjithatë, pengesat administrative mbetën. Por puna dhe suksesi i tij morën një tjetër vlerësim.

Ura që çoi talentet drejt “Partizanit”

Pas ndërhyrjes së Mehmet Shehut u mor një vendim i rëndësishëm. Sherif Çiçiku u emërua trajner i dytë i ekipit “Partizani”, ndërsa dhjetë futbollistë të ekipit “Skënderbej” kaluan menjëherë tek të rinjtë e klubit të madh ushtarak.

Ky vendim vulosi rolin e shkollës si furnizuesja kryesore e “Partizanit” me talente. Pikërisht këtu qëndron edhe merita më e madhe e Sherif Çiçikut. Ai nuk ishte thjesht trajner. Ai ishte zbulues talentesh.

Profesori i qindra futbollistëve

Lista e futbollistëve që kanë kaluar nga duart e tij është mbresëlënëse.

Mes tyre spikasin emra legjendarë të futbollit shqiptar si: Perlat Musta, Agim Murati, Neptun Bajko, Hasan Lika, Artur Lekbello, Suvorov Seferi, Gjergj Thaka, Bashkim Muhedini, Fatmir Leli, Vasil Sotiri, Arjan Ahmeti dhe dhjetëra futbollistë të tjerë që kanë luajtur me “Partizanin”, “Vllazninë” dhe ekipet më të mira të vendit.

Secili prej tyre ka marrë nga Sherif Çiçiku jo vetëm njohuri teknike, por edhe kulturën e punës, disiplinën dhe frymën e sakrificës.

Nga “Skënderbeu” në Federatën

Shqiptare të Futbollit

Mbyllja e Shkollës “Skënderbej” në vitin 1992 shënoi fundin e një epoke. Por jo fundin e kontributit të Sherif Çiçikut.

Ai vazhdoi të punonte në Federatën Shqiptare të Futbollit deri në vitin 2007. Edhe pas pensionit mbeti pranë futbollit dhe pranë talenteve të rinj. Shumë prej tyre kanë vazhduar karrierën në akademi prestigjioze në Gjermani dhe Spanjë.

Një trashëgimi që jeton

Në historinë e sportit ushtarak shqiptar ka shumë trajnerë dhe pedagogë.

Por pak prej tyre mund të krenohen se kanë ndikuar në formimin e kaq shumë sportistëve dhe personaliteteve sa Sherif Çiçiku. Ai mbetet simbol i përkushtimit, pasionit dhe dashurisë për futbollin. Një figurë që ndërtoi ura mes sportit ushtarak dhe futbollit kombëtar.

Një trajner që nuk kurrë lavdi për vete, por investoi gjithçka për suksesin e nxënësve të tij.

Krijimi, Organizimi dhe Funksionimi i Spitaleve Partizane gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare: Rasti i Shpellës së Ramicës në Smokthinë



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Organizimi i Spitaleve Partizane në Shqipëri dhe Rëndësia e Shpellës së Ramicës në Zonën e Parë Operative

Qendrat e qëndrueshme (stacionare) shërbyen si baza për kalimin në një fazë të re dhe pikërisht në atë të krijimit të spitaleve partizane. Këto qendra formën e tyre të plot e morën pas gushtit të vitit 1943, kohë e cila mund të konsiderohet edhe si fillim i kësaj faze të LANÇ-it. Zgjerimi dhe organizimi i ushtrisë partizane ndikoi edhe në zgjerimin dhe përsosjen e shërbimit shëndetësor partizan. Në vijim të këtyre masave organizative, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, i krijuar në Labinot të Elbasanit, më 10 korrik 1943, më 17 gusht të vitit 1943, duke u nisur nga kërkesat dhe nevojat e ngutshme të luftës lëshoi urdhrin e krijimit dhe të organizimit të spitaleve partizane. Ky urdhër dhe një sërë aktesh të tjera përcaktojnë mënyrën e funksionimit të spitaleve partizane. Po kështu u sh-truan dhe detyra të veçanta për personelin mjekësor, për mjekët dhe infermierët. Ndërsa në një urdhëresë tjetër të Shtabit të Përgjithshëm përcaktohen me hollësi detyrat e mjekut dhe të infermierit. Ja çfarë thuhet në këtë dokument: “...para së gjithash mjeku duhet të jetë i sjellshëm, i ndërgjegjshëm, i kujdesshëm, i shpejtë në diagnostikimin dhe terapinë e sëmundjes, i dashur dhe i urtë, të jetë i duruar dhe i palodhur ndaj të sëmurëve, sidomos ndaj luftëtarëve të plagosur, të cilët mund të jenë të traumatizuar...”. Kurse për personelin e mesëm ndihmësmjek dhe infermierët bëhej e qartë se: “... pas mjekut edhe ata janë përgjegjës për punën mjekësore në spitalin partizan, bashkëpunojnë me mjekun, ndajnë punën, mbajnë barnat, ushqimet, si dhe bëjnë ndarjen e tyre. Ata gjithashtu duhet të kujdesen për ruajtjen e mirëmbajtjen e veglave mjekësore, si dhe pastrimin e të sëmurëve...”.

Spitali i parë partizan në Zonën e Parë Operative

Qendër mjekësore e shërbimi mjekësor partizan fillimisht për zonën e Vlorës ka qenë në Shpellën e Ramicës, Smokthinë. Kjo i ka fillimet e veta dhe ka funksionuar si qendër mjekësore nga janari i vitit 1943. Mjeku dr. Ibrahim Dervishi ka mjekuar dhe shëruar të plagosurit e parë në Luftën e Gjormit në dhjetor 1942-janar 1943. Më 25 gusht 1943, në Shpellën e Ramicës u krijua i pari Spital Partizan për Zonën e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër. Këtë shembull e ndoqën edhe të tjerë spitale si në Kuç të Kurveleshit, në fshatin Katund të zonës së Vakëfeve të Korçës, Voskopojë, Hoçisht, Topovë, Nivan, Poliçan të Gjirokastrës, Leshicë e Sipërme në Përmet etj. Spitalet partizane u shërbenin Zonave Operative, Grupeve partizane dhe formacioneve të mëdha. Ato ishin vendosur tërësisht në zona të thella e kryesisht të çliruara e të sigurta, si dhe në pozicione të tilla që lejonin zhvendosjen dhe manovrimin e shpejtë të tyre me qëllim që në rast nevojë të dislokoheshin në një zonë tjetër më të thellë e më të sigurt. Spitalet ishin të vendosura kryesisht nëpër shtëpitë e patriotëve atdhetarë apo në shkolla e godina të tjera, në ndonjë një rast edhe në çadra fushore apo tenda të thjeshta me degë pylli. Këto shtëpi-spitale, ktheheshin në vende mjekimi e shërimi për qindra e qindra partizanë. Gjithashtu spitalet partizane janë vënë në shërbim edhe të popullsisë civile vendase. Nga ana tjetër, popullsia e zonave në të cilat ishin ngritur spitale ndihmonte aktivitetin e mbarëvajtjen e këtyre spitaleve jo vetëm në vënien në shërbim të ambienteve



ku jetonin, por edhe në drejtim të shërbimit ndaj partizanëve të plagosur, apo duke siguruar dhe përgatitur ushqim për ta.

Shpella e Ramicës në Smokthinë

Spitalet partizane të krahinës së Smokthinës, ashtu si në gjithë Shqipërinë, në fillimet e LANÇ-it, mjekimi i partizanëve



të plagosur e të sëmurë bëhej me shumë vështirësi. Në fillim të plagosurit lehtë mjekoheshin në çetë e batalion nga luftëtarë që ishin ngarkuar me shërbimin mjekësor. Të sëmurët apo të plagosurit më rëndë strehoheshin në banesat e fshatarëve për mjekim e kujdes të mëtejshëm. Një qëndrim shembullor kanë mbajtur fshatarët e Smokthinës për sa i përket trajtimit të partizanëve të sëmurë apo të plagosur. Traditat e mjekësisë popullore të kësaj krahine, kujdesi dhe ruajtja e konspiracionit për të mos zbuluar familjet që mbanin partizanë të plagosur, bënë që të kuroheshin me sukses dhjetëra e dhjetëra partizanë e partizane. Në Shpellën e Ramicës në Smokthinë, Vlorë, u ngrit e para infermieri në janar të vitit 1943, duke u dhënë ndihmën mjekësore partizanëve të plagosur të zonës së Mesaplikut. Më 25 gusht të vitit 1943, kjo infermieri u shndërrua në spitalin e parë partizan të zonës.

Shpella është mijëravjeçare dhe njihet ndryshe edhe me emrin “Shpella e Çine”. Ajo gjendet në një vend shkëmbor e malore të mbrojtur dhe ka një sipërfaqe rreth 300 m². Brenda ajo ndahet me mure shkëmbore, duke krijuar përshtypjen e ndarjes në dhoma. Ka ngushtime e zgjerime me përmasa mesatare 10-15 m. Zgjerimi më i madh ka formën e një kubeje. Lartësia mbi nivelin e detit është 1000 m. Shpella ka përgjithësisht temperaturë konstante e veçanërisht në dimër ndjehet më ngrohtë se sa në ambientin e jashtëm.

Në zbatim të urdhrit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së, për krijimin e spitaleve partizane, ishin caktuar dhe qendrat ku do të mjekoheshin partizanët e plagosur të zonës. Shpella e Ramicës, u shndërrua në spital partizan. Këtë e dëshmon veterania Shaniko Burhanaj, ku shkruan se kur u plagos e dërguan për mjekim në spitalin që ndodhej në guvën e Ramicës. Atje e mjekuan dr. Ibrahim Dervishi dhe ndihmësja e tij, Drita Kosturi ose Lumja, siç e thërrisnin, e cila pas vrasjes së Qemal Stafës ishte dërguar në zonën e Vlorës. Plagët, thotë ajo, i kisha shumë të rënda. Meqë armiku na ndiqte, spitali disa herë u shpërngul.

Në luftën e Drashovicës, forcat partizane morën materialet e spitalit fushor, farmacinë e pajisur me medikamente dhe depot me materiale të shumta ushtarake. Robërit italianë u lanë të lirë. Në kontingjentin e forcave italiane bënë pjesë dhe 13 mjekë dhe infermierë, të cilët iu bashkuan forcave partizane.

Në Spitalin e Ramicës kanë shërbyer fillimisht dr. Ibrahim

Dervishi, dr. Petro Cani, i cili më vonë ka shërbyer heroikisht në zonën e Qarkut të Korçës, Shëngjergjit të Tiranës, Zerqanit, të Dibrës e së fundi në Spitalin e Përgjithshëm Ushtarak në Tiranë, dr. Grigor Konomi, dr. Grigor Dahiu si dhe një mjek Italian. Ky spital pati pajisje të mira e medikamente relativisht të mjaftueshme, pasi ishin materiale të kapura nga italianët në betejën e Drashovicës. Për arsye të rrethanave të luftës, ky spital ka qenë i detyruar të shpërngulej disa herë, madje në disa raste, ta copëzonte aktivitetin e tij dhe, për këtë arsye, në këtë periudhë ndeshemi me mjaft spitale lëvizëse. Në dhjetor të vitit 1943 deri më shkurt të vitit 1944, u hap spitali partizan i Smokthinës në Bodën të Çipinit. Në fillim të Operacionit armik të Dimrit, ky spital iu bashkua spitalit partizan të Kuçit në Kurvelesh. Me futjen e forcave gjermane të ardhura nga Saranda, në fshatin Kuç, spitali partizan i vendosur në këtë fshat, u detyrua të evakuohet dhe mars të vitit 1944 e gjejmë të bashkuar me spitalin e Poliçanit të Gjirokastrës. Është e kuptueshme që një shpërngulje e tillë në kushtet e Dimrit të madh të 1944, si dhe të represionit të egër që ushtronin forcat naziste ka qenë tepër e vështirë. Veterania Pashko Dautaj në vitin 1944 i këndonte kështu Shpellës së Çine, në Ramicë: *O shpellë e Çine/ O zemra ime/ Në halle jeshe streh ime/ Aty u bënë shumë mjekime/ Se gjermanët dogjën shtëpinë time.*

Kuadri shëndetësor i luftës

Spitalet partizane kanë patur që në fillim një karakter kurativo-profilaktik. Kirurgjia e plagëve të luftës, sidomos ato të shkaktuar nga armët e zjarrit, zinte një vend të rëndësishëm në aktivitetin e tyre. Ajo kryej nga kuadro të aftë e të profilizuar, por shpesh edhe nga ish-studentë mjekësie stazhierë, që ende nuk e kishin përfunduar fakultetin dhe me mjete të pakta mjekësore, madje shpesh kur urgjenca e marrjes së masave nuk priste, edhe me mjete të improvizuara rrethanore si sharra, pinca për heqjen e plumbave apo copave të predhave, gërshtë, mjete të mprehta etj. Me krijimin e spitaleve të para partizane u rrit ndjeshëm edhe puna profesionale për rritjen e njohurive të personelit të mesëm e të ulët. Për këtë ndikoi së tepërmi edhe përfshirja në radhët e ushtrisë të një numri gjithnjë e më të madh mjekë e studentë nga mjekësia, por edhe përvoja tashmë e përfituar gjatë 2-3 viteve aktiviteti luftarak.

Për medikamentet, baza kryesore për sigurimin e tyre ishin farmacitë ekzistuese nëpër komuna e qytete me anën e blerjeve të rregullta nga organet kompetente të LANÇ-it, blerjet sistematike jashtë shtetit, kryesisht në Itali nga ana e firmës private që drejtohej nga luftëtari Naum Stralla, i cili gjatë LANÇ-it ka kryer blerje të rregullta medikamentesh. Rugë tjetër për sigurimin e medikamenteve ishin rrëmbimet masive që u bëheshin spitaleve të ushtrisë armike me anën e aksioneve të njësiteve guerile. Medikamentet janë siguruar gjithashtu dhe nga spitalet apo farmacitë e qyteteve. Në fazat e mëvonshme të LANÇ-it një ndihmë të konsiderueshme për sigurimin e medikamenteve dhe mjeteve mjekësore kanë dhënë ndihmat e aleatëve Anglo-Amerikanë, madje me krijimin e kushteve të përshtatshme shumë nga të sëmurët e të plagosurit u transportuan në spitalet e sanatoriumet e tyre me anën e mjeteve detare në qytetet e çliruara të Italisë. Gjatë fazave të ndryshme të LANÇ-it shumë punonjës të ndryshëm të shëndetësisë si mjekë, ndihmësmjekë, infermier, farmacistë, sanitarë, pa marrë parasysh rrezikun që u kanosej, kanë dhënë një kontribut të çmuar shërbim të anëtarëve të njësiteve guerile, partizanëve të sëmurë apo të plagosur, si dhe popullatës. Qëndrimi sa atdhetar aq dhe profesional i personelit shëndetësor në luftë ishte i lidhur ngushtë me vetë natyrën humane të profesionit të mjekut, por nga ana tjetër dëshmon edhe për sensin e lartë patriotik dhe të përgjegjësisë qytetare që ata ndjenin për fatet e luftës dhe të kombit. Punonjës të këtij shërbimi të rëndësishëm e human të çdo niveli që janë burgosur, internuar apo pushkatuar për shkak të aktivitetit të tyre profesional në shërbim të lirisë dhe pavarësisë së vendit. Mjekët edhe në burgje apo në kampet e përqendrimit e kanë ushtruar aktivitetin e tyre mjekësor në shërbim të jetës. Të tillë kanë qenë mjekët Ibrahim Dervishi, Spiro Lito, Mihal Angjeli, të cilët pushtuesi fashist i internoi në ishujt e Italisë, ndërsa mjekët Mihal Konomi, Dhimitër Kutulla në kampet gjermane. Infermiere si Dhimitra Trajani në kampin e Prishtinës, Fato Berberi, Sofie Noti, Dhoksi Dhame në kampin nazist të përqendrimit në Selanik të Greqisë. Jo të paktë kanë qenë mjekët apo punonjësit e tjerë të shëndetësisë, të cilët angazhimin e tyre në shërbim të luftës antifashiste e kanë paguar edhe me jetën e tyre, duke rënë Dëshmorë të Atdheut. Shpella e Ramicës, me vendim nr. 676, datë 20. 12. 2002 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës shqiptare”, është shpallur monument kulture.



Një realitet që po afrohet

Shkencëtarët paralajmërojnë se njerëzimi mund të jetë duke hyrë në fazat e hershme të një zhdukjeje masive të gjashtë. Studimi i publikuar në “Biological Reviews” nga Prof. Robert Cowie në Universitetin e Havait thekson se humbja e biodiversitetit nuk është më një rrezik i largët, por një proces që ka nisur të ndodhë. Ky alarm global ngre pyetje të mëdha mbi të ardhmen e jetës në Tokë dhe mbi rolin e njerëzimit si faktor kryesor i krizës.



Shenjat e para të një katastrofe ekologjike

Në shumë rajone të botës, popullatat e specieve po bien me ritme alarmante. Shumë lloje zhduken pa u dokumentuar, duke humbur përgjithmonë nga historia e natyrës. Ekosisteme të brishta si pyjet tropikale, koralet dhe zonat e lagështa po humbasin aftësinë e tyre për të mbajtur jetë. Shkencëtarët vërejnë se këto janë pikërisht simptomat që kanë shoqëruar zhdukjet masive të së kaluarës, duke e bërë krahasimin edhe më shqetësues.

Faktorët që po e përshpejtojnë zhdukjen

Ndryshimet klimatike janë një nga motorët kryesorë të krizës, duke sjellë temperatura ekstreme, thatësira dhe përmytje që shkatërrojnë habitatet natyrore. Urbanizimi dhe bujqësia intensive po zëvendësojnë tokat e gjelbra me beton dhe monokultura, duke lënë pak hapësirë për biodiversitetin. Ndotja nga plastika dhe kimikatet po dëmton zinxhirët ushqimorë, ndërsa speciet invazive të sjella nga aktiviteti njerëzor destabilizojnë ekosistemet. Për më tepër, shfrytëzimi i tepruar i burimeve natyrore – peshkimi, gjuetia dhe prerja e pyjeve – po zhduk lloje të tëra.

Pasojat për njerëzimin

Humbja e biodiversitetit nuk është thjesht një problem ekologjik. Ajo prek drejtpërdrejt ekonominë, shëndetin dhe stabilitetin shoqëror. Prodhimi i ushqimit dhe furnizimi me ujë varen nga ekosisteme të shëndetshme. Shkatërrimi i tyre rrit rrezikun e krizave ushqimore dhe shëndetësore. Për më tepër, krizat mjedisore mund të sjellin konflikte për burime dhe migrime masive, duke krijuar tensione të reja globale. Në këtë kuadër, zhdukja e specieve nuk është thjesht humbje e natyrës, por një kërcënim i drejtpërdrejtë për civilizimin.

Thirrja për veprim

Studimi është një alarm i qartë: pa ndryshime të mëdha në politikat mjedisore dhe sjelljen e individëve, rreziku i një zhdukjeje masive bëhet gjithnjë e më real. Shkencëtarët



Paralajmërimet për një Zhdukje Masive të Gjashtë



kërkojnë politika të forta për mbrojtjen e habitateve, investime në energji të pastër dhe bujqësi të qëndrueshme. Edhe veprimet individuale kanë rëndësi – reduktimi i konsumit të plastikës, zgjedhjet e qëndrueshme në ushqim dhe transport, si dhe ndërgjegjësimi për pasojat e konsumit të tepruar. Pa një mobilizim të gjerë, pasojat do të jenë të pakthyeshme.

Shkencëtarët paralajmërojnë se njerëzimi mund të jetë duke hyrë në fazat e hershme të një zhdukjeje masive të gjashtë. Studimi i publikuar në “Biological Reviews” nga Prof. Robert Cowie në Universitetin e Havait thekson se humbja e biodiversitetit është një proces që ka nisur dhe nuk është më thjesht një rrezik teorik. Ky alarm global ngre pyetje të mëdha mbi të ardhmen e jetës në Tokë.

Amazona - Mushkëritë e planetit në rrezik

Amazona, e njohur si “mushkëritë e Tokës”, po humbet sipërfaqe të mëdha pyjesh çdo vit për shkak të shpyllëzimit dhe bujqësisë intensive. Humbja e pyjeve tropikale jo vetëm që zhduk mijëra specie të panjohura, por edhe ul aftësinë e planetit për të thithur dioksid karboni. Ky proces përshpejton ndryshimet klimatike dhe krijon një cikël të rrezikshëm që ushqen krizën ekologjike.

Arktiku - Një botë që po shkrihet

Në Arktik, akullnajat po shkrihen me ritme rekord. Kjo jo vetëm që rrezikon speciet e përshtatura për klimën e ftohtë, si arinjtë polarë, por edhe ndikon në rritjen e nivelit të

detit global. Shkrimja e akullit hap rrugë për shfrytëzimin e burimeve natyrore, duke sjellë më shumë ndotje dhe presion mbi ekosistemet e brishta të rajonit.

Mesdheu - Kriza e biodiversitetit në brigjet tona

Rajoni i Mesdheut po përballë me zhdukjen e bletëve dhe insekteve të tjera polenizuese, të cilat janë jetike për prodhimin e ushqimit. Urbanizimi i shpejtë, përdorimi i pesticideve dhe ndryshimet klimatike po e bëjnë këtë zonë një shembull të qartë të krizës së biodiversitetit. Humbja e bletëve rrezikon zinxhirin ushqimor dhe ekonominë bujqësore të vendeve përreth.

Oqeanet - Një botë e heshtur nën ujë

Koralet, të cilat janë baza e jetës detare, po zbardhen dhe po zhduken për shkak të ngrohjes së ujërave dhe acidifikimit të oqeanëve. Pa to, miliona specie detare humbasin habitatin e tyre. Peshkimi i tepruar dhe ndotja nga plastika e përkeqësojnë situatën, duke e bërë jetën nën ujë gjithnjë e më të brishtë.

Pasojat për njerëzimin

Këto shembuj tregojnë se humbja e biodiversitetit nuk është një problem i largët. Ajo prek prodhimin e ushqimit, furnizimin me ujë, stabilitetin ekonomik dhe shëndetin publik. Krizat mjedisore mund të sjellin konflikte për burime dhe migrime masive, duke krijuar tensione të reja globale.

Një moment vendimtar

Zhdukja masive nuk është një skenar i largët, por një proces që ka nisur. Njerëzimi ka ende mundësi të ndryshojë rrjedhën e historisë, por koha për veprim është e kufizuar. Ky është një moment vendimtar ku shkenca, politika dhe shoqëria duhet të bashkohen për të mbrojtur jetën në Tokë. Nëse nuk veprojmë tani, brezat e ardhshëm mund të trashëgojnë një planet të varfëruar dhe të rrezikuar.





**Formim profesional dhe
disiplinë që hapin dyert
për karrierë të suksesshme.**

QENDRA E
PERSONELIT
REKRUTIMIT

MUNDËSI E ARTË PËR KARRIERË USHTARAKE!

Qendra e Personel Rekrutimit shpall hapjen e aplikimeve për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë për vitin akademik 2026–2027.

Ky është shansi yt për të ndërtuar një të ardhme të sigurt, prestigjioze dhe plot mundësi zhvillimi profesional.

Në dispozicion janë vetëm 5 kuota ekskluzive:

Forca Tokësore (Evelpidon) – 1 kuotë

Forca Detare (SNS) – 1 kuotë

Oficerë të Shërbimeve të FA (SASS) – 3 kuota në:

- Mjekësi – 1 kuotë
- Juridik – 1 kuotë
- Informatikë – 1 kuotë

Afati i aplikimit: deri më 03 korrik 2026

Informacion i plotë:
[urlkub.co/2xbXBX](https://www.mod.gov.al/publikime/gazeta-ushtria)

Pse të aplikosh?

Arsimi i lartë ushtarak në një nga akademitë më të njohura të rajonit.

Mundësi për të qenë pjesë
e elitës ushtarake dhe
akademike.